



## Bashkëpunimi Rajonal si Forcë Shtytëse për Rritje Ekonomike dhe Stabilitet

Rezultate dhe Rekomandime  
të Konferencës Rajonale  
4 Nëntor 2014

Abdylmenaf Bexheti  
Adrian Civici  
Srdjan Dizdarevic  
Ardian Hackaj  
Frank Hantke  
Hellmut Hoffmann  
Dušan Janjić  
Elvina Jusufaj  
Arben Malaj

Rexhep Meidani  
Ilir Meta  
Agim Nesho  
Stevo Pendarovski  
Željko Perović  
Zef Preci  
Arber Vllahiu  
Romana Vlahutin

# Bashkëpunimi Rajonal si Forcë Shtytëse për Rritje Ekonomike dhe Stabilitet

Rezultate dhe Rekomandime  
të Konferencës Rajonale, 4 Nëntor 2014

Abdylmenaf Bexheti  
Adrian Civici  
Srdjan Dizdarevic  
Ardian Hackaj  
Frank Hantke  
Hellmut Hoffmann  
Dušan Janjić  
Elvina Jusufaj  
Arben Malaj

Rexhep Meidani  
Ilir Meta  
Agim Nesho  
Stevo Pendarovski  
Željko Perović  
Zef Preci  
Arber Vllahiu  
Romana Vlahutin

## Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Rajonale

### Bashkëpunimi Rajonal si Forcë Shtytëse për Rritje Ekonomike dhe Stabilitet

**Botimi i broshurës u mundësua nga:**

**Fondacioni “Friedrich Ebert”**

Zyra e Tiranës

Rruga: “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 2273306; Fax: +355 04 2262067

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Viti i botimit: 2014

Përkthyer nga:

Ledia Marku

Redaktoi:

Elvina Jusufaj

Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura ne kete botim jane te autoreve dhe nuk reflektojne domosdoshmerisht ato te Fondacionit Friedrich-Ebert.

*Publikimet e FES-it nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim!*

## Rekomandime të Konferencës

1. Aktivitetet dhe konferencat rajonale kontribuojnë në të ardhmen e rajonit dhe në fuqizimin e diplomacisë kulturore. Intensifikimi i aktiviteteve rajonale, konferencave, eventeve akademike dhe kulturore, do të shtojë mundësitë për afrimin me njëri-tjetrin dhe rritjen e komunikimit përmes shkëmbimit të praktikave, përvojave, mësimëve të nxjerra dhe njohurive.
2. Pajtimi dhe gjithëpërfshirja janë hapat e nevojshëm për të përmbushur integrimin rajonal si hapin e parë drejt Integritimit Evropian.
3. Përmbushja e kriterëve të anëtarësimit në BE, mbi të gjitha forcimi i shtetit të së drejtës, si kriteri më i rëndësishëm për të arritur objektivat e tjera. Përmbushja e këtij parimi i kontribuon rritjes ekonomike. Lufta kundër korrupsionit, reduktimi i informalitetit ekonomik, etj, do të zvogëlojë kostot e transaksionit dhe rrisë efikasitetin e investimeve.
4. Krijimi i një modeli Ballkanik të bashkëpunimit ekonomik, bazuar në modelet e mëparshme të suksesshme të bashkëpunimit rajonal. Krijimi i një qendre të tillë ekonomike do t'ju mundësojë shteteve të rajonit që të lidhen me qendrat e tjera të mëdha dhe me ndikim ekonomik, të tilla si Bashkimi Evropian. Krijimi i zyrave rajonale të koordinimit do të jetë një nga hapat e mëtejshëm për koordinim më të mirë të politikave dhe bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.
5. Zhvillimi ekonomik dhe vullneti politik janë të ndërlidhura ngushtë dhe do të nxisë jo vetëm bashkëpunimin më të ngushtë rajonal, por do të sjellë gjithashtu paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon.
6. Përmirësimi i infrastrukturës është një nga mjetet kryesore për të lidhur rajonin dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta infrastrukturore do të sjellë vendet dhe qytetarët e saj më pranë njëri-tjetrit.
7. Thellimi i katër lirive ekonomike – të mallrave, kapitalit, krahut të punës dhe shërbimeve – është në qendër të bashkëpunimit ekonomik
8. Politikat ekonomike, të bazuara në patriotizëm dhe nacionalizëm duhet të shmangen si të dëmshme, pasi ato krijojnë pengesa dhe „luftë“ tregtare ndërmjet vendeve për mallrat e ndryshme.
9. Konvergenca ekonomike duhet të krijohet ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në nivelin e politikave të zhvillimit. Integrimi European duhet të konsiderohet jo si një aneks por si një mekanizëm plotësues për zhvillimin ekonomik
10. Dialogu Kosovë-Serbia, si një nga çështjet më të rëndësishme të marrëdhënieve rajonale, duhet të intensifikohet. Njohja e realitetit të Kosovës nga ana e Serbisë është një hap tjetër përpara që nxit më tej bashkëpunim më të ngushtë dhe integrimin rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
11. Organizatat e shoqërisë civile, si promovuese të paqes, dialogut dhe procesit të integritimit Evropian

duhet të mbështeten nga Bashkimi Evropian, pavarësisht qëndrimeve të autoriteteve lokale ndaj aktorëve të shoqërisë civile.

- 12.** Shoqëria civile duhet të bashkëpunojë në mënyrë aktive në rajon dhe të jetë një alternativë e fuqishme në mbështetje të nismave rajonale dhe të përqendrohet në mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve, në mbrojtje të parimeve të demokracisë liberale.
- 13.** Shoqëria civile e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të ketë prioritet të aktivitetit të saj edhe luftën kundër terrorizmit. Kjo lind nga nevoja e rritjes së fundamentalizmit, pjesëmarrjes në luftën në Iran, Siri, dhe rreziku nga riatdhesimi i luftëtarëve nga rajoni. Kjo luftë duhet të ngrihet në të gjitha nivelet, në edukim, në parandalim, në rehabilitim dhe në sensibilizimin e shoqërisë. Kjo luftë kërkon një bashkëpunim rajonal dhe angazhim të vazhdueshëm ndër-institucional.

## Përmbatja

Rekomandimet e Konferencës .....	3
Parathënie	
Frank Hantke, Drejtor i FES .....	7
Agim Nesho, President i Këshillit Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë.....	9
Programi i Konferencës .....	11
Ilir Meta, Kryetar i Parlamentit .....	12
Romana Vlahutin, Ambasadore e Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri .....	15
Hellmut Hoffmann, Ambassador i Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri .....	17
Rexhep Meidani, Ish-President i Republikës.....	19
Panel: Integrimi Rajonal si parakusht për integrimin European .....	22
Željko Perović, Drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit, Mali i Zi.....	22
Arber Vllahu, Drejtor Kabineti, Presidenca e Republikës së Kosovës.....	24
Stevo Pendarovski, Macedonia.....	26
Dušan Janjić, President i Bordit Ekzekutiv, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd .....	28
Srdjan Dizdarevic, President, Human Rights House, Bosnia -Herzegovina .....	30
Gjetjet kryesore të Panelit të Parë.....	32
Panel: Shteti i së Drejtës dhe Rritja Ekonomike si kritere themelore për Integrim.....	33
Abdylmenaf Bexheti .....	33
Adrian Civici, President i Universitetit European të Tiranës .....	35
Zef Preci, Drejtor Ekzekutiv, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike .....	37
Arben Malaj, President, Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje .....	39
Gjetjet Kryesore të Panelit të Dytë .....	41
Panel: Shoqëria Civile si një aktor i rëndësishëm për Integrimin European .....	42
Elvina Jusufaj, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë.....	42
Ardian Hackaj, Shteti Web .....	44
Gjetjet Kryesore të Panelit të Tretë.....	46
Konkluzione: Profesor Rexhep Meidani.....	47





## Parathënie



### Frank Hantke

Drejtor

Fondacioni Friedrich Ebert

### Bashkimi Evropian është një rajon i fqinjësisë

Fondacioni Friedrich-Ebert punon në të gjitha vendet e Ballkanit që nga vitet '90. Që nga fillimi i veprimtarisë tonë bashkëpunuese një nga objektivat më të rëndësishëm është mbështetja për krijimin e fqinjësisë së mirë. Dy ishin arsyet kryesore. Arsyeja e parë ishte të ndihmoheshin vendet për të kapërcyer periudhën e luftërave në mënyrë paqësore dhe me perspektiva favorizuese. Arsyeja e dytë ishte mbështetja në bashkëpunimin ekonomik dhe social mes vendeve fqinje, pasi ka shume përvoja të mira në Bashkimin Evropian që në pikënisjen të tij.

### Nisja e një fqinjësie të mirë – Fillesat e projektit të Bashkimit Evropian

Vetëm pak vite pas Luftës së Dytë Botërore, politikanët dhe ekonomistët e dy vendeve ish-armike, Francës dhe Gjermanisë, filluan një projekt shumë ambicioz të bazuar në motive të përbashkëta ekonomike. Më vonë, hap pas hapi, ky projekt u shndërrua në Bashkimin Evropian, i cili është ende i bazuar në të njëjtin perceptim: Vendet me tregti dhe interesa të përbashkëta ekonomike dhe sociale nuk sulmojnë njëri-tjetrin. Pra, BE u bë aleanca e parë, e cila nuk mbështetej në motive ushtarake por në ato sociale dhe ekonomike. Sot brezat e rinj në BE as nuk mund të imagjinojnë se Evropa e mëparshme ishte zona e shumicës së luftërave dhe djepi i luftërave botërore. Qytetarët Francezë, Britanikë, Danezë, Gjermanë dhe Polakë u bënë miq dhe BE-ja u shndërrua në strukturën më të rëndësishme për paqe, stabilitet dhe mirëqenie. Sigurisht jo çdo gjë është zgjidhur në mënyrën më të mirë dhe sigurisht ka ende shumë pengesa për bashkëpunim më të ngushtë. BE-ja mbetet një projekt për Evropën dhe ka ende për të përmbushur por kjo do të ndodhë vetëm së bashku me vendet e Ballkanit.



## **Përgjegjësi e përbashkët – Bashkimi Europian së bashku me shtetet e Ballkanit**

Nga kjo pikëpamje të dyja palët, vendet e BE-së dhe vendet Ballkanike që aspirojnë për aderim, ndajnë të njëjtën përgjegjësi për një Evropë të përbashkët paqësore dhe të begatë. Bazuar edhe në përvojën e mirë të vendeve të Europës Veriore dhe Perëndimore, ekziston gjithashtu një mënyrë për bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit, madje edhe të kenë kontakte miqësore. Ashtu siç vepruan shtetet e Europës Perëndimore në vitet '50, shtetet Ballkanike duhet të fillojnë të intensifikojnë fillimisht tregtinë dhe biznesin e tyre dy-palësh dhe shumë-palësh që do të kontribuojë drejt arritjes së fqinjësisë së mirë. Kjo do të ulë mosbesimin, madje edhe antagonizmin e hershëm. Në të njëjtën kohë do të rrisë integrimin ekonomik dhe social. Të dyja këto mundësi - ulja e antagonizmit dhe rritja e integritit - janë parakushte për një anëtarësim të ardhshëm në BE.

## **Një detyrë e përbashkët – anëtarësimi në BE nuk është një detyrë vetëm për politikanët por edhe për qytetarët**

Ashtu siç kemi mësuar që nga fillimet e BE-së, integrimi nuk mund të zotërohet vetëm nga politikanët. Përkundrazi, ishte i nevojshëm motivimi i qytetarëve të shteteve për integrim. Ata u bënë motori i projektit evropian. Përveç tregtisë dhe biznesit të përbashkët në shumë fusha, u zhvilluan një sërë programesh ndërveprimi për qytetarët, duke filluar me të rinjtë. Krahas tyre qëndronte gjithashtu edhe ideja për organizimin e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në proceset politike - jo vetëm si pjesëmarrës rastësorë por si bashkë-aktorë të nevojshëm dhe kompetentë. Këto ide janë përmendur gjithashtu si faktorë të rëndësishëm për integrimin në Konferencën e Ballkanit Perëndimor në Berlin.

Kjo konferencë “Bashkëpunimi rajonal si forcë shtytëse për rritje ekonomike dhe stabilitet” është një prej shumë hapave të nevojshëm dhe të rëndësishëm për një proces integrimi të përbashkët të vendeve të Ballkanit. Ne kemi nevojë për një bashkëpunim më të besueshëm dhe më pak konkurrencë ndërmjet njëri-tjetrit.



### **Agim Nesho**

President i Këshillit Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë

Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal midis vendeve të Ballkanit është kyç për integrimin evropian dhe zhvillimin ekonomik të tyre. Bashkësia ndërkombëtare ka qenë gjithmonë e pranishme dhe i ka kushtuar vëmendje të veçantë rajonit. Ndihma e tyre është konstante për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe financiar, si dhe për të rritur demokracinë funksionale. Konferenca e fundit për Ballkanin Perëndimor, zhvilluar në Berlin më 28 gusht 2014, e iniciuar nga Kancelarja Merkel, është një shtysë e re për të arritur objektivin tonë madhor - anëtarësimin përfundimtar në familjen evropiane.

Ballkani Perëndimor mbetet ende rajoni i fundit gjeografik për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Përveç Kroacisë, që u anëtarësua në 2013, Mali i Zi ka arritur në përfundimin me sukses të procesit të shqyrtimit për të gjithë kapitujt negociues dhe dymbëdhjetë kapitujt negociues janë hapur, ndërsa Serbia ka nisur zyrtarisht negociatat e pranimit. Maqedonia është një vend kandidat që prej 2005, dhe Shqipëria së fundmi. Bosnja dhe Hercegovina duket të jetë vendi që mbetet prapa, ndërsa statusi i pazgjidhur ndërkombëtar i Kosovës ende mbetet një çështje për diskutim. Hyrja në BE e Rumanisë, Bullgarisë, Sllovenisë dhe Kroacisë, së fundmi, mund të shërbejë për të inkurajuar shtetet e mbetura të Ballkanit për të ndjekur procesin e tyre të transformimit dhe më tej rrugën e tyre të integritimit në BE. Prandaj, është e domosdoshme për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin rajonal në të gjitha nivelet, si një mjet për të arritur stabilitetin në aspektin politik dhe ekonomik.

Forcimi i shtetit të së drejtës në vendet e rajonit përmes zbatimit të funksionimit të institucioneve të pavarura demokratike, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ekonomisë së tregut, duke pranuar vlerat e normat demokratike të Bashkimit Evropian, është objektivi kryesor që do të kontribuojë në krijimin e një rrjeti vendesh që operojnë me të njëjtat standarde dhe aspirata.

Emëruesi i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor është fakti që problemet e brendshme kanë penguar gjithmonë procesin e integritimit të tyre në institucionet Euro-Atlantike. Ajo që është e preferueshme nga bashkësia ndërkombëtare është që rajoni të ndajë të njëjtin vizion ndaj kërkesës së tyre për integrimin në BE dhe mundësisht të veprojnë me të njëjtën shpejtësi. Vendet e Ballkanit Perëndimor, përpara integritimit të tyre në BE, duhet të arrijnë integrimin e tyre të brendshëm rajonal. Në fakt, shtetet

e Ballkanit kanë punuar me vite të tëra për të lëvizur më pranë BE-së, duke përmirësuar legjislacionin në përputhje me standardet e BE dhe në përgjithësi në përpjekje për të përmbushur kërkesat e BE sa më shpejt të jetë e mundur. Pa këtë perspektivë, proceset e modernizimit dhe reformës në shumë prej shteteve të Ballkanit dhe bashkëpunimi rajonal si një i tërë, do të kishin qenë edhe më të ngadalta dhe mbi të gjitha, stabiliteti i rajonit do të kishte qenë edhe më i brishtë. Për këtë arsye, është detyrë e Ballkanit Perëndimor për të krijuar ide, për të marrë në konsideratë iniciativa të reja dhe për të vënë në praktikë arritjet e iniciativave të mëparshme, ndërkohë që integrimi i tyre bëhet realitet. Integrimi rajonal do të sjellë këto vende më pranë dhe do të lehtësojë procesin e tyre të integritit. Një bashkëpunim intensiv dhe më i thellë rajonal ndërmjet Ballkanit Perëndimor është me rëndësi të madhe jo vetëm për arritjen e suksesshme të procesit të tyre të integritit në BE dhe plotësimin e kriterëve për anëtarësim por edhe për gjenerimin e ideve për të intensifikuar bashkëpunim më të ngushtë rajonal.

## Programi i Konferencës

10.00 h	<p>Fjala e mirëseardhjes, <b>Agim Nesho</b>, President i KSHMJ</p> <p>Folës kryesorë, SH. T. Z. <b>Ilir Meta</b>, Kryetar i Parlamentit</p> <p>Sh. S. Znj. <b>Romana Vlahutin</b>, Ambasadore e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri</p> <p>Sh. T. Z. <b>Hellmut Hoffmann</b>, Ambasador i Republikës Federale Gjermane në Shqipëri</p> <p><b>Profesor Rexhep Meidani</b>, Ish-President i Republikës së Shqipërisë</p>
<b>Paneli i Parë: Integrimi Rajonal si Parakusht për Integrimin Europian</b>	
10.30 h	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ambasador Željko Perović</b>, Drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Europian, Mali i Zi</li> <li>• <b>Z. Arber Vllahu</b>, Drejtor Kabineti, Presidenca e Republikës së Kosovës</li> <li>• <b>Profesor Stevo Pendarovski</b>, Maqedoni</li> <li>• <b>Dr. Dušan Janjić</b>, President i Bordit Ekzekutiv, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Serbi</li> <li>• <b>Z. Srdjan Dizdarevic</b>, President i Human Rights House, Bosnia dhe Herzegovina</li> <li>• Diskutime</li> </ul> <p>Moderator: <b>Frank Hantke</b>, Drejtor, FES</p>
12.15 h	Pushim për kafe
<b>Paneli i Dytë: Shteti i së Drejtës, Rritja Ekonomike si kriteret themelore për Integrim Shoqëria civile si një aktor i rëndësishëm për Integrimin Europian</b>	
11.30 h	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Profesor Abdylmenaf Bexheti</b>, Maqedoni</li> <li>• <b>Profesor Adrian Civici</b>, President i Universitetit UET</li> <li>• <b>Znj. Elvina Jusufaj</b>, Drejtor Ekzekutiv, KSHMJ</li> <li>• <b>Z. Zef Preci</b>, QSHKE</li> <li>• <b>Z. Ardian Hackaj</b>, Shteti-Web</li> <li>• Diskutime</li> </ul> <p>Moderator: <b>Professor Arben Malaj</b>, Instituti Për Politika Publike dhe Mirë-Qeverisje</p>
13.15 h	<p>Konkluzionet e Konferencës</p> <p>Profesor <b>Rexhep Meidani</b>, Ish President i Republikës së Shqipërisë</p>



## **Ilir Meta**

Kryetar i Parlamentit

Republika e Shqipërisë

Dua të falënderoj Ambasador Neshon, sepse unë kështu e quaj gjithmonë, për ftesën. Dua të shpreh kënaqësinë që jam këtu në këtë mjedis mjaft domethënës bashkë me ish-Presidentin e nderuar, Prof. Rexhep Mejdani, me përfaqësues të nderuar të Parlamentit, të mazhorancës dhe të opozitës, të Ministrisë së Jashtme dhe institucioneve, me shumë ambasadorë përfaqësues të Bashkimit Evropian, Gjermanisë, por dhe vendeve të tjera e organizatave të tjera partnere dhe me shumë përfaqësues të nderuar të shoqërisë civile.

Nuk do të doja të mbaja ndonjë fjalë të gjatë, për arsye sepse kjo është një temë e rrahur shpesh gjatë gjithë këtyre viteve dhe ajo që duhet, dhe që besoj se doli qartë edhe nga Konferenca e Berlinit është se tani duhet një bashkëpunim më konkret në disa akse strategjike, që e kthejnë bashkëpunimin rajonal në një domosdoshmëri për të përfituar jo vetëm sa më shumë paqe dhe stabilitet, por edhe për të prodhuar sa më shumë mirëqenie dhe prosperitet për të gjithë qytetarët e rajonit tonë, pa dallim përkatësie etnike.

Nuk ka nevojë të kthehemi 100 vet prapa për të kuptuar rëndësinë e stabilitetit, sepse të gjithë e dimë se çfarë ndodhi 100 vjet më parë në Ballkan, por edhe në të gjithë kontinentin. Nuk ka nevojë të kthehemi as 15 apo 17 vjet prapa për të kuptuar sa e rëndësishme dhe e domosdoshme është paqja dhe stabiliteti por njëkohësisht edhe nuk ka nevojë të kthehemi as tre javë prapa për të parë se si në një ndeshje futbolli mund të kemi një rikthim të retorikave që i takojnë të së kaluarës. Që do të thotë se në kaq kohë në Ballkan është bërë mjaft për stabilitetin, për paqen, për integrimin dhe mjafton të kemi parasysh se disa vende tashmë janë candidate përfshirë edhe Shqipërinë, Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi. Padyshim që edhe Bosnje-Hercegovina dhe Kosova e kanë vendin në Bashkimin Evropian dhe kjo është e përcaktuar qartë për të mos folur për Kroacinë, që është anëtarja më e re e këtij rajoni në Bashkimin Evropian dhe një shpresë, që ky proces të vazhdojë dhe me vendet e tjera. Por është e domosdoshme të kuptojmë se nuk na duhet thjesht stabiliteti politik në Ballkan, thjesht për të evituar luftën. Kjo tani do të ishte një kërkesë fare minimale për vendet tona, për shoqëritë

tona, për popujt tanë, për qytetarët tanë dhe natyrisht për elitat politike intelektuale shoqërore të këtyre vendeve dhe të gjithë rajonit. Tani mendoj se sfida jonë është se si këtë bashkëpunim rajonal ta kthejmë në një shtysë të fuqishme për zhvillimin dhe për progresin ekonomik e social të gjithë rajonit. Jetojmë në një proces globalizimi, por në radhë të parë unë do të theksoja se ekonomia sot në botë para se të jetë globale, përsëri është rajonale. Dhe në këtë drejtim krijimi i një bashkëpunimi më efektiv dhe i një koncepti më të ndërgjegjësuar në të gjitha vendet tona për të fuqizuar dimensionin ekonomik të rajonit si një i tërë, do të na ndihmonte të fuqizonim edhe dimensionin ekonomik dhe perspektivën e secilit prej vendeve tona. Pra, të mos i shohim gjërat në një plan të ngushtë të interesave afatshkurta, por në një plan më afatgjatë, në mënyrë që rajoni të ketë mundësi të krijojë jo vetëm besueshmëri më të madhe, pra që ky është një rajon i sigurt, ku paqja dhe stabiliteti nuk kanë kthim prapa, por edhe përmes një bashkëpunimi më aktiv, më konkret dhe më pragmatik të kemi mundësi të krijojmë bindjen, që në këtë rajon jo vetëm siguria është e padiskutueshme, por në këtë rajon mund të bëhet biznes pa rrezikuar. Këtu kam parasysh investitorët e mëdhenj, të cilët çdo vend tonin e shohin si një treg mjaft të kufizuar për të investuar, ndërkohë që e theksoj se ekonomia është në radhë të parë rajonale dhe ka rajone të tjera shumë më të mëdha, shumë më atraktive, shumë më joshëse për investimet, për kapitalet e huaja në vende të tjera të botës.

Ne kemi nevojë për këtë mirëkuptim dhe për këtë solidaritet në mënyrë që ne të përfitojmë maksimumin për vendet tona dhe për qytetarët tanë, sepse po të vazhdojmë të merremi me histori të së kaluarës do të tregojmë që jemi të paafte për të mësuar nga ajo që ka ndodhur 100 vjet më parë dhe nga ajo që ka ndodhur 15 vjet më parë apo dhe nga ato emocione që shpërthyen para disa javësh në një ndeshje futbolli ku politika u përzje dhe më shumë se lojtarët dhe tifozët. Them këtë sepse përgjegjësia jonë është për fëmijët tanë në radhë të parë, është për gjeneratat që duan të jetojnë më mirë dhe në paqe të padiskutueshme, ashtu sikurse është e sigurtë që moszhvillimi ekonomik do ta kthejë rajonin mbrapa, do ta rrisë frustimin, do të zgjojë problemet etnike, do të na çojë në konflikte të paevitueshme. Pra të dyja këto janë mjaft të lidhura me njëra-tjetrën sepse për çështjen e historisë dhe për çështjen e kufijve dhe për çështjen e hapësirave që mund t'i takojnë një kombi apo një kombi tjetër, kjo mendoj se është një çështje e zgjidhur në Ballkan, është e zgjidhur sepse çdo komb në Ballkan është diku shumicë në një shtet dhe diku pakicë.

Dhe nuk ka asnjë zgjidhje për asnjë komb përveç asaj që të gjithë të respektojmë kufijtë dhe të gjithë të respektojmë në raport me pakicat të njëjta standarde, standardet evropiane. Vetëm kjo e ka zgjidhur dhe e zgjidh përfundimisht problemin e së ardhmes së këtij rajoni. Ndaj e theksoj se bashkëpunimi rajonal, duhet shfrytëzuar tani jo thjesht për të garantuar një stad minimal të stabilitetit politik në kuptimin e shmangies së konflikteve dhe të rrezikimit të paqes, por në stadin e një zhvillimi më të avancuar ekonomik edhe rajonal. Marrëveshja e tregtisë së lirë CEFTA, natyrisht që ka qenë vetëm një instrument i cili është i pamjaftueshëm në rast se nuk avancohet me një axhendë rajonale të investimeve, gjë që u theksua edhe në Konferencën e Berlinit para disa muajsh. Në këtë drejtim unë do të nënvizoj edhe rëndësinë e instrumentit financiar të Bashkimit Evropian për nxitjen e këtyre investimeve, që shpresoj të jetë edhe më dobiprurës në të ardhmen dhe natyrisht mbetet e rëndësishme të zhvillojmë ato korridore të cilat krijojnë baza më të qëndrueshme për një zhvillim më të shpejtë të të gjithë rajonit dhe qarkullimit të mallrave, të njerëzve, të kapitaleve. Sidomos në rastin tonë do të theksoja rëndësinë e avancimit më konkretisht të Korridorit 8 apo edhe të Korridorit “Blu”. Dua të shpreh kënaqësinë për progresin e zhvilluar vitet e fundit në lidhje me linjat e interkonjeksionit, sikurse kemi atë midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, apo aktualisht Shqipërisë dhe Kosovës dhe në të ardhmen shpresojmë edhe mes Shqipërisë me Maqedoninë. Janë të dobishme, jo thjesht për vendin tonë, por janë të dobishme për të gjithë rajonin dhe doja të falënderoja në veçanti edhe KFW-në për ndihmën e jashtëzakonshme që ka dhënë në mbështetje të programeve rajonale për energjinë në mënyrë të veçantë, ashtu sikurse progresin



në drejtim të realizimit të TAP-it apo të IAP-it, që do t'i japë një dimension tjetër bashkëpunimit rajonal, por do t'i japë mundësi të reja zhvillimit të ekonomisë në vendet tona. Në fushën e turizmit, absolutisht që edhe në këtë drejtim mbetet shumë për të bërë, për të shkuar drejt ofrimit të një pakete turistike rajonale, ashtu sikurse edhe në fushën e parqeve industriale dhe rajonale, duhet menduar më shumë në të ardhmen. Ky rajon do të jenë konkurrent vetëm nëse harmonizon praktikat e biznesit mes vendeve tona në mënyrë që të krijohet një treg mbi 20 milionë konsumatorë, i aftë për të tërhequr investime strategjike. Shpesh interesat e ngushta çojnë në krijim konfliktesh jo transparente, të cilat pastaj mund të kthehen në përplasje midis vendeve të ndryshme apo qeverive të ndryshme. Këtu kam parasysh për shembull disa raste që kemi pasur, jo me ndonjë vend tjetër të rajonit, por me një vend që ne e kemi shumë pranë, siç është Kosova.

Kemi pasur historinë e çimentos, tani ka dalë historia e miellit. Janë histori interesash, grupesh lobiste në Kosovë apo në Shqipëri. Këto çështje mund të zgjidhen vetëm përmes politikave transparente, përmes diskutimeve, përmes vendosjes së standardeve të cilat duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjitha vendet. Dhe natyrisht standardet, përderisa të gjitha vendet janë në një rrugë të qartë të integritimit evropian dhe synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, janë vetëm ato. Por natyrisht që nëse një debat i tillë do të ishte hapur me një vend tjetër si me Maqedoninë apo me Malin e Zi apo me Serbinë, do të merrte përmasa të tjera dhe debati do të politizohej kur në fakt nuk janë interesa politike, por janë interesa ekonomike të grupeve të caktuara të cilat synojnë të përfitojnë apo të dëmtojnë rivalët e tyre në treg duke përdorur politikën dhe vendimmarrjen.

Si shmanget kjo? Vetëm përmes transparencës dhe vetëm përmes vendosjes së standardeve të përbashkëta, sepse në rast se çdo vend do të përpiqet të krijojë pengesa për tregtinë e lirë, do të shohë interesat e ngushta momentale të një grupi të caktuar apo dhe të vetë vendit, do të krijojë një klimë mosbesimi dhe do të dëmtojë besueshmërinë e këtij tregu si një treg rajonal ku hyjnë dhe duan të hyjnë edhe shumë aktorë të tjerë të përmasa të tjera.

Unë besoj se historia na ka mësuar që Ballkani prodhon më shumë konflikt sesa konsumon. Tani është momenti që të prodhojmë më shumë bashkëpunim në mënyrë që të fitojmë atë kohë të humbur për shumë gjenerata dhe për rajonin dhe mbi të gjitha të fitojmë të ardhmen e fëmijëve tanë. Kjo është më e rëndësishme se sa t'i referohemi gjithnjë së kaluarës. Për të kaluarën duhet të lëmë historianët. Ajo që ne duhet të bëjmë është të fitojmë të ardhmen e përbashkët evropiane. Kemi këtë fat të madh që të gjitha vendet dhe të gjithë qytetarët tanë synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, jo si një qëllim në vetvete, por si një instrument për të garantuar edhe paqen, edhe prosperitetin për qytetarët tanë, për shoqëritë tona. Atëherë le të punojmë konkretisht në këtë drejtim.

Faleminderit për vëmendjen!





### **Romana Vlahutin<sup>1</sup>**

#### **Ambasadore, Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri**

Mirëdita, Jam shumë e lumtur që gjendem këtu sot. Falënderime për organizatorët.

I nderuar zoti Kryetar, Shkëlqesia Juaj ish-Presidenti Meidani.

Kjo është tryeza më e natyrshme për mua për të diskutuar këto çështje. Të ulur rreth të njëjtës tryezë, paraqitje e prezantimeve dhe angazhim serioz në dialog dhe diskutime për mënyrën sesi rajoni mund ti afrohet Bashkimit European, sa të jetë e mundur dhe sa më shpejt të jetë e mundur.

Gjendem sot gjithashtu në pozicionin e një lloj dualiteti, si kreu i delegacionit të BE-së por edhe e ardhur nga ky rajon. E lindur në brigjet e Detit Adriatik, shumë pranë Tiranës, dhe kjo e bën për mua këtë diskutim shumë më të rëndësishëm.

Kam qenë e angazhuar në çështjet e bashkëpunimit rajonal për shumë vite. Por dicka po e kuptoj tani. Nëse për shumicën e Ballkanit Perëndimor, bashkëpunimi rajonal nënkuptonte pajtimin, për Shqipërinë ai nënkupton përfshirjen. Ky është një element mjaft rëndësishëm që i bashkohet tablosë së bashkëpunimit rajonal dhe asaj se çfarë duhet të bëjmë.

Desha të shtoj diçka tjetër. Kujtoj diskutimet për ndërlidhjen e politikës me ekonominë. Për një kohë të gjatë ekzistonte filozofia që nëse do të kishte vetëm bashkëpunim ekonomik do të zgjidheshin të gjitha problemet e tjera. Por kjo provoi jo e vërtetë. Çfarë me të vërtetë vjen para çdo përpjekje tjetër janë bazat politike që janë të përcaktuara për të gjitha elementet e tjera të bashkëpunimit, duke përfshirë ekonominë. Sot ne kemi avancuar shumë më tepër në këto baza politike dhe unë mendoj se kemi arritur në fazën ku ne mund të vendosim ngrehinën, por ka ende disa gjëra të rëndësishme që duhen bërë për rritjen e këtij rajoni dhe afërsinë e saj me BE-në.

---

1. Fjala e prezantuar gjatë Konferencës Rajonale “Bashkëpunimi Rajonal si forcë shtytëse për rritje ekonomike dhe stabilitet”, Tirana, 4 Nëntor 2014.

Çështja e parë është lidhja mes rajonit. Kam lindur në një qytet bregdetar që është vetëm 277 km nga Tirana. Duhet rreth 6 orë për të arritur atje, në qoftë se udhëtojmë me shpejtësi 50- 60 km në orë. Srdjan do ta dijë se për të arritur nga Sarajeva në Tiranën duhet përafërsisht e njëjta kohë për të udhëtuar nga këtu në Uashington. Kur isha e vogël, treni nga Zagrebi do të arrinte në Beograd në katër orë. Sot duhet rreth shtatë orë e gjysmë - tetë orë për të njëjtin udhëtim me të njëjtin tren, në të njëjtën rrugë. Ne nuk mund të jetojmë dhe të rritemi në shekullin e 21 me shpejtësinë e shekullit të 19-të. Mendoj se në këto momente ky është prioriteti themelor dhe me përparësi për këtë rajon. E rëndësishme është se ky është edhe prioriteti i Komisionerit të ri për Zgjerimin, Komisioneri Hahn, dhe ju do ta dëgjoni fjalën “lidhje” shumë më shpesh në të ardhmen se më parë. Korridori 8, Korridori 10, Korridori 5C, Autostrada Blu, janë projekte për realizimin e të cilave do të na duhet të bashkojmë mendjet, energjitë dhe paratë dhe të bëjmë gjithçka mundemi tani, dhe jo pas 10, 15, 20 apo 30 vitesh së ardhme. Mendoj se nuk mund të humbasim më kohë pasi pa këtë realitet do të jetë e pamundur jo vetëm rritja ekonomike portë gjitha llojet e shkëmbimit social kulturor, apo rritjen civilizuese, që do të duhet të ndodhë në rajon.

Çështja e dytë që e mendoj si prioritare është dija – akumulimi i dijes dhe mobiliteti i dijes. Së pari, në terma legjislativ apo pengesash të mundshme, të cilat duhet të mënjanohen për njohjen e kualifikimeve. Por duhet gjithashtu të punojmë për krijimin e aftësive, transferimit të teknologjisë, krijimin e rrjeteve të ekselencës. Shkëmbimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Vërtetë besoj se njerëzit që kanë të njëjtat probleme mundën dhe janë në pozicione më të favorshme për gjetjen e zgjidhjeve së bashku.

Prioriteti i tretë është i përcaktuar – arritja e standardeve të Bashkimit Europian. Mendoj se standardet e BE-së duhet të jenë korniza absolute për gjithçka realizohet në këtë rajon, dhe duhet të nisë nga shteti i së drejtës. Shteti i së drejtës është reforma themelore për çdo shtet të Ballkanit Perëndimor, pasi pa të do të ishte e pamundur krijimi i një lloji besimi dhe parashikueshmërie, që është e rëndësishme jo vetëm për marrëdhëniet dypalëshe mes shteteve të rajonit por edhe në marrëdhëniet me BE-në. E gjitha kjo është e mundshme vetëm nëse ka angazhim këmbëngulës politik. Kjo është edhe arsyeja për të cilën ne e konsiderojmë të rëndësishme vizitën e Kryeministrit Rama në Beograd, diçka të cilës do të kushtojmë vëmendje të madhe. Është e rëndësishme të avancojmë sa më shumë të jetë e mundur, dhe mendoj se afrimi me BE-në do të kërkojë lëvizje më të guximshme në të ardhmen. Duhet të jemi të gatshëm për këtë. Si komunitete politike, analistësh, etj, ne duhet të krijojmë kontakte për të inkurajuar elitat politike që të marrim në duart tona fatin dhe të ardhmen e këtij rajoni në mënyrë që të hidhen hapa dhe të na mundësojë që të bisedojmë për hapjen e negociatave, jo në afat të gjatë, bashkimin me BE-në jo në një afat të gjatë, dhe BE është e gatshme për t’ju ndihmuar në realizimin e saj.



### **Ambasadori Hellmut Hoffmann**

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë

Z. Kryetar,  
Z. Nesho,  
Zonja dhe Zotërinj,

Pse ka rëndësi bashkëpunimi rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor? Përgjigja është shumë e thjeshtë: Bashkimi Europian është një sistem i integritit rajonal të shteteve-kombe. Një sistem i tillë është i mundur vetëm nëse dhe kur fqinjët, pjesë e këtij sistemi ose aspirantë për tu bërë pjesë e tij, zgjidhin problemet serioze që kanë me njëri-tjetrin dhe mësojnë të punojnë së bashku në një mënyrë produktive, përndryshe i gjithë koncepti i integritit rajonal të shteteve-kombeve nën çatinë e përbashkët të Bashkimit Evropian do të ishte absurd.

Por „Brukseli“, e thënë ndryshe qeverisja përmes dhe nga institucionet qendrore të BE-së, nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet - në qoftë se BE-ja do të jetë e suksesshme, shumëçka duhet të ndodhë nga poshtë-lart.

Njerëzit sot janë më të ndërgjegjësuar se në të shkuarën, se ishte një gabim i rëndë të pranoheshin në BE shtete të cilat kishin probleme themelore me fqinjët. Mësimi i nxjerre është i qartë: BE-ja duhet të kërkojë që probleme të tilla të zgjidhen mes palëve përkatëse në një mënyrë të pranueshme para anëtarësimit, në mënyrë që këto probleme të mos importohen në BE për shkak të të gjitha pasojave negative që mund të sillte në rast të kundërt. Pra, kjo nënkupton se mungesa ose, kur është e nevojshme, zgjidhja e problemeve serioze të fqinjësisë përbën standardin minimal.

Nuk është e vështirë për të përmendur një sërë çështjesh të cilat duhet të adresohen dhe të zgjidhen deri-diku një moment në Ballkanin Perëndimor, si p.sh. çështja e emrit të shtetit të Maqedonisë, çështja e statusit/njohjes së Kosovës, çështja lidhur me kufirin detar Shqipëri-Greqi, dhe më gjerësisht marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Serbisë. Në lidhje me këtë të fundit, ne mirëpresim zhvillimin brenda pak ditësh të vizitës së parë të një Kryeministri të Shqipërisë në Beograd, pas një periudhe të gjatë mbi 60 vjeçare.

Por përtej zgjidhjes së problemeve të vjetra, ajo që sigurisht është e dëshirueshme është bashkëpunimi rajonal *proaktiv*. Një bashkëpunim i tillë mund të zhvillohet në nivele të ndryshme: në nivelin shtet-me-shtet, por edhe në një nivel nën-rajonar, që është rasti më i mirë i njohur i bashkëpunimit të rajoneve kufitare përgjatë kufijve shtetërorë. Një shembull i mirë është bashkëpunimi i nën-rajonit përreth Liqenit Constance në Austri, Gjermani dhe Zvicër, i cili ka dhënë praktikisht rezultate shumë të mira.

Në pikëpamje të historisë së tensioneve dhe konflikteve në Ballkan forcimi i bashkëpunimit rajonal shtet me shtet duket se ka një rëndësi të veçantë. Ka shumë forma për zhvillimin e një bashkëpunimi të tillë. Por është e rëndësishme është që ky bashkëpunim të tejkalojë nivelin e zakonshëm të komunikatave të fryra verbale që burojnë nga vizitat rutinë fqinjësore dhe takimet e një numri të madh të nismave rajonale dhe të materializohet në projekte konkrete dhe të prekshme të bashkëpunimit fqinjësor dhe/ose rajonal. Nuk ka asnjë arsye për tu shqetësuar se pritshmëria e një veprimi të tillë proaktiv do të ishte i barazvlefshëm me detyrimin e shteteve drejt marrëdhënieve të padëshiruara politike. Lidhur me këtë, më kujtohet kur isha me Ambasadën Gjermane në Zagreb, në mes të viteve 1990, sesi kroatët ishin shumë dyshues se rekomandimi i BE-së për angazhim në mënyrë më aktive në bashkëpunimin rajonal mund të ishte një skemë ogurzezë për ti detyruar ata drejt një Jugosllavie të re.

Ka shumë mundësi për ta çuar përpara bashkëpunimin rajonal në Ballkan. Infrastruktura e transportit është një mundësi, përmes përfundimit të autostradës Adriatiko-Joniane ose rehabilitimit të sistemit hekurudhor, të neglizhuar në të gjithë rajonin. Mund të mendohet edhe përdorimi i aeroporteve rajonale në një mënyrë të koordinuar ndërmjet kufijve shtetërorë, në mënyrë që të shmanget humbja e burimeve (p.sh. aeroporti i Janinës në Greqi që është vetëm 100 km larg Sarandës në Shqipëri).

Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë shtete të vegjël, disa prej tyre shumë të vegjël, që është një pengesë e dukshme për investimet e huaja direkte. Sa më efektivisht të bashkëpunojnë këto shtete në nivel rajonal në fusha të ndryshme, aq më tërheqëse do të bëhen ato për investitorët, pasi investitorët do të mirëpresin gjithçka që mund të ndihmojë në zgjerimin e tregjeve.

Në aspektin politik, një shembull i mirë për bashkëpunim të suksesshëm rajonal të shteteve kandidate për anëtarësim në BE, është bashkëpunimi i Visegradit midis Republikës Çeke, Hungarisë, Polonisë dhe Sllovakisë, i cili ka qenë shumë i dobishëm në koordinimin e pozicioneve të këtyre shteteve.

Një nga objektivat kryesore të Konferencës së Ballkanit Perëndimor në Berlin më 28 gusht 2014, të zhvilluar me ftesë të Qeverisë Gjermane, është ndihma për vendet e rajonit në forcimin e bashkëpunimit mes tyre, p.sh., duke i inkurajuar ato për tu mbledhur së bashku dhe të përpunojnë projekt-propozimet me rëndësi strategjike rajonale. Unë jam i kënaqur të theksoj se kjo ka çuar ndërkohë në shqyrtimin e projekteve konkrete të infrastrukturës, jo vetëm nga ana e këtyre shteteve por edhe nga organet përkatëse të BE, kështu që ka perspektiva të mira për në konferencën e ardhshme në Vjenë, në gushtin e vitit të ardhshëm, për të marrë vendime operative mbi disa projekte.

Në përfundim, do të theksoja që, bashkëpunimi proaktiv rajonal në mënyrën që u përpoqa të përshkruaj, është sipas kuptimit tim, jo një kërkesë ligjore ose formale për anëtarësim në BE, por norma e pranuar gjerësisht të sugjeron që ky bashkëpunim mund të ndihmojë shumë për të avancuar më tej dhe shumë më shpejt në atë drejtim.



## Profesor Rexhep Meidani

Ish President i Republikës së Shqipërisë

### *Fjalë hyrëse*

Siç kuptohet, sot, në bashkëveprimin rajonal, kanë një peshë të konsiderueshme 3 rrjete bazike: a) *tregtia e komunikimi* dhe e telekomunikimit me infrastrukturën përkatëse, b) *energjia e mjedisi* dhe c) *media* (tradicionale e sociale); por, mund të shtohen dhe dy “forca” të tjera: 1. *Demografia* me problemet e *punësimit, edukimit kulturor, barazisë gjinore e migrimit* njerëzor; - 2. *Ndërlidhja depërtuese dhe e gjithanshme* në të gjithë vendet e rajonit. Madje, në këtë kuptim integrimi rajonal, siç u përcaktua edhe takimin e Berlinit të 28 gushtit, është një premisë thelbësore e integritimit evropian. Pikërisht, në shënimin poshtë kam komentuar shkurtimisht disa iniciativa rajonale në funksion të integritimit evropian<sup>2</sup>.

**2. 1. Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore** (*Southeast European Cooperation Process - SEECP*) si iniciativë e propozuar nga Bullgaria, në vitin 1996, për fuqizimin e bashkëpunimit rajonal, për rritjen e nivelit të sigurisë dhe situatës politike, intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe ndërveprimin në fushën e burimeve njerëzore, demokracisë, drejtësisë, luftës kundër aktiviteteve ilegale e kriminale. Synimi bazë ishte integrimi i vendeve anëtare në strukturat euro-atlantike dhe evropiane.

**2. Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore** (*Stability Pact for South Eastern Europe- SP*). Pakti i Stabilitetit ishte përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj krizës në ish Jugosllavi me një strategji preventive e përfshirëse. Në 10 qershor 1999, me iniciativën e BE-së, u adoptua në Këln dokumenti i Paktit të Stabilitetit, ku mbi 40 vende partnere e organizata u angazhuan për të ndihmuar në *përpjekjet e vendeve të Evropës Jug- Lindore për fuqizimin e paqes, demokracisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe prosperitetit ekonomik, për arritjen e paqes dhe stabilitetit në të gjithë rajonin*. Pakti i Stabilitetit u riafirmua në Samitin e Sarajevës, më 30 korrik 1999. Në shkurt 2008, ky pakt u zëvendësua nga Këshilli i Kooperimit Rajonal (RCC), për të fituar një pamje apo “ngjyrë” më tepër rajonale.

**3. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore.** (*Central European Free Trade Agreement - CEFTA*). Ajo është një marrëveshje tregtie midis vendeve të ish socialiste të CEE-së, jo anëtare të BE-së. Të tillë kanë mbetur: Bosnja-Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Serbia e Shqipëria. (Kjo anëtarësi ndërpritet me integrimin në BE).

**4. Iniciativa e Evropës Qendrore** (*Central European Initiative - CEI*). Ajo, si organizatë politike, ekonomike, kulturore e shkencore, është themeluar në vitin 1989. Aty përfshihen 18 vende anëtare Austria, Bjellorusia, Bosnja- Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Italia, Mali i Zi, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Shqipëria e Ukraina. Që në fillim, objektivi kryesor ishte ndihma ndaj vendeve në tranzicion në përpjekjet e tyre për integrimin evropian dhe arritjen e një niveli të kënaqshëm të zhvillimit social-ekonomik. Në kontekstin e një zgjerimi në vazhdimësi të BE-së, roli i CEI-së është fokusuar në vendet anëtare ende jashtë BE-së (vendet e Ballkanit Perëndimor,



1. Në mënyrë të veçantë tepër shpresëdhënës ka qenë Pakti i Stabilitetit. Ai ushqeu pritshmëri të larta për projekte infrastrukturore; ndërkohë që më shumë u punua për kontakte e komunikim, ndërveprim e reformim ideor; madje mjaft kohë e para u shpenzuan për seminare e konferenca. Po ashtu, aty, nga koncepti i Ballkanit u kalua tek koncepti i Evropës Juglindore; që me integrimin e Bullgarisë e Rumanisë u shndërrua në “*termin*” Ballkan Perëndimor. Në këtë kuptim duhen parë dhe “10 miliardët” e deklaruar nga ish presidenti i Komisionit Evropian Barroso; aq më tepër që kërkohen të mbështeten *projekte të përbashkëta*.

- Gjithashtu, deri tani, në Ballkan (Evropën Juglindore) është realizuar integrimi me 3 *shpejtësi*. Konkretisht: I. Sllovenia (01.05.2004 - në *Big Bang*-un Evropian); II. Rumania e Bullgaria (01.01.2007) dhe III. Kroacia (01.07.2013). Edhe në Ballkanin Perëndimor do të ishte më i këshillueshëm dhe më pak problematik integrimi i përbashkët në një fazë të tretë, duke konsideruar fazë të parë atë të Sllovenisë (edhe pse ajo vetë nuk e pëlqente përkatësinë në Ballkan!), dhe të dytë atë të Kroacisë, Pra, në një të ardhme të afërt, të gjithë vendet e mbetura: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja-Hercegovina, do të ishte mirë të anëtarësoheshin së bashku në BE. Në këtë kuptim, edhe integrimi rajonal midis këtyre vendeve e përshpejton integrimin e tyre në BE. Ai është një parakusht i këtij të fundit.

- Por, në funksion të bashkëveprimit rajonal dhe atij me BE-në si e tërë, apo me vende anëtare të saj në plan individual, duhen shfrytëzuar dhe iniciativa të tjera për projekte të përbashkëta rajonale. E tillë është dhe iniciativa 16+1 - CEE (16 vende të Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore) dhe Kina (1) që, në total, mund të arrijnë në realizimin e investimeve të përbashkëta në një shumë të parashikuar prej 10 miliardë dollarësh. Veçse, ashtu si në takimin e Berlinit të 28 gushtit, kjo iniciativë apo iniciativa të tjera të ngjashme duhen zgjeruar, duke përfshirë dhe vende të tjera, p.sh., Kosovën, që u përfaqësua në Berlin si e *barabartë midis të barabartëve*...

2. Ngjarja e shëmtuar sportive në Beograd dhe reagimet politike, dëshmojnë për një rajon ende me reminishenca nacionaliste e urrejtje etnike. Ndaj tyre duhen gjetur zgjidhje në nivel rajonal, duke ushqyer mbi të gjitha, ndërveprimin ekonomik, sidomos atë në projekte të përbashkëta rajonale në fusha të ndryshme. Pra, së bashku, rritja ekonomike është më e garantuar. Nga ana tjetër, lufta e përbashkët kundër korrupsionit, krimit ekonomik e terrorit është pjesë e përpjekjeve, jo si thjesht e kërkesave të integritit, por si nevojë e vetë shoqërive tona.

Tepër i rëndësishëm është ndërveprimi në fusha që lidhen me zbatimin e ligjit, me sigurinë, paqen e mirëkuptimin. Pra, kërkohet një angazhim i përbashkët dhe i sinqertë në fushën e sigurisë; gjetja e përgjigjeve ndaj çështjeve shqetësuese dhe e zgjidhjeve të nevojshme. P.sh., cili është motivimi i të rinjve nga e gjitha bota, përfshirë dhe ata të shkolluar; apo radhitja e tyre nën flamurin e IS? Përse ata janë

përfshirë dhe Kosovën, apo vendet e tjera si Bjellorusia, Moldavia e Ukraina).

5. **Iniciativa e Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore** (*Southeast European Cooperative Initiative - SECI*) është propozuar në 1995 dhe përpunuar më tej në vitin 1996, me një ide fillestare aplikimin e një modeli të tipit të *Planit Marshall* (1947), që ndihmoi në rindërtimin e Evropës së pas Luftës. Në vitin 2009, u krijua dhe Këshilli i Kooperimit Rajonal (*Regional Cooperation Council -RCC*), me objektiv paqen, demokratizimin dhe fuqizimin ekonomik. Vende anëtare janë: Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Jugosllavia (Serbia & Mali i Zi), Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Shqipëria, Sllovenia, Turqia.

6. **Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi** (*Black Sea Economic Cooperation - BSEC*). BSEC, me seli në Stamboll, lindi më 1992, si një iniciativë politike e ekonomike multilaterale, për të forcuar bashkëveprimin dhe harmoninë midis 11 vendeve anëtare, për të garantuar paqen, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, stabilitetin dhe prosperitetin në rajonin e Detit të Zi. Në vitin 1997 u themelua dhe *Banka e Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi* (*Black Sea Trade and Development Bank - BSTDB*) si një institucion financiar ndërkombëtar dhe objektiv mbështetjen e zhvillimit ekonomik, kooperimit rajonal, nxitjes së tregtisë dhe financimit të projekteve të përbashkëta të ndërmarrjeve publike apo private, të vendeve anëtare. Kapitali i autorizuar i saj në vitin 2009 vlerësohej afro 1.5 miliardë dollarë. *Vendet themeluese* të BSEC janë: Armenia, Azerbajxhani, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Moldavia, Rumania, Rusia (Federata Ruse), Shqipëria, Turqia e Ukraina (më vonë dhe Serbia).

të gatshëm të vrasin dhe të vriten në vende fare të panjohura për ta si Siria e Iraku, përse i nënshtrohen një “predikimi” të panjohur më parë nga prindërit e komunitetet e tyre, deri për të pranuar e ushqyer një veprim të tillë barbar si prerja e kokës!... Pra, ndryshe nga disa deklarata politike patetike e alarmuese, mbi rrezikun e ISIS (ISIL) në rajonin tonë, duhet punuar në çdo vend të tij për rindërtimin e besimit midis njerëzve, feve e etnive.

3. Dhe, këtu, një rol të veçantë ka luajtur, po luan dhe do të luajë shoqëria civile; siç janë p.sh., në Shqipëri, Këshilli shqiptar, IDM, etj. Një balancë e re politike, por dhe vlerësim i ri nevojitet për binome të tillë si: *Stabilitet- Demokraci* apo *Demokraci-Efektivitet*. Për këtë, vlen analiza, pse jo dhe zgjidhja e konflikteve të ngrira. Të tillë janë në rajon raportet Maqedoni- Greqi për emrin e Maqedonisë dhe bllokimin e procesit të anëtarësimit të Maqedonisë në NATO, marrëdhëniet Serbi- Kosovë, lidhur me njohjen e shtetit të Kosovës, etj<sup>3</sup>. Në zgjidhjen e tyre; ashtu si dhe në situata të tjera kritike, duhen intensifikuar, edhe dy mekanizma kryesorë: ai i *diplomacisë kulturore dhe ai i diplomacisë ekonomike*; pavarësisht që në ndeshjen sportive në Beograd ndodhi e kundërta.

---

3. Por, të tillë konflikte të ngrira në botë, janë, të shumtë, p.sh.: *marrëdhëniet e “ngrira” Indi- Pakistan* në lidhje me çështjen e Kashmirit (që nga 1947), *ndarja e Koresë* (1953), *konflikti arab-izraelit* me çështjen palestineze në zemër të tij (“i ngrirë” që në 1948); konflikti i vjetër serb-shqiptar me një përpjekje për zhblokim në takimet dypalëshe në Bruksel, *konflikti në Saharë në Perëndimore* (1991); *ndarja e Qipros* (1974); *situata në Transnistria- Moldavi* (1992); *lufta në Nagorno- Karabak* midis Azerbajxhanit e Armeninë (1994); *konflikti Abkhazi-Gjeorgji* (2008); *konflikti Oseti - Gjeorgji* (2008), të dy me mbështetje ruse; apo *konflikti i sotëm Ukrainë- Rusi* me prirjen e Kremlinit për ta trajtuar atë si të ngrirë, pas aneksimit të Krimesë, etj.



❖ *Panel i Parë - Integrimi Rajonal si kusht paraprak për Integrimin European*

*Moderator – Frank Hantke*



**Ambasador Zeljko Perovic**

Drejtor i Përgjithshëm

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit European

Republika e Malit të Zi

Ballkani ka qenë gjithmonë një zonë e trazuar. Në këtë pjesë të botës, në çerekun e fundit të shekullit, katër luftëra të përgjakshme janë ndërmarrë, me viktima të shumta dhe shkatërrim. Pas përfundimit të luftërave, filloi faza e bisedimeve dhe negociatave mes vendeve, dhe me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë u krijuan shtatë shtete të reja.

Unë do të thoja se tani po jetojmë në kohën e perspektivave të mëdha për Ballkanin. Megjithatë, ende duhet t'i mbajmë sytë hapur për të shmangur sfidat me të cilat jemi përballur në historinë tonë. Për fat të keq, kemi qenë dëshmitarë, më shumë se një herë, se çdo gjë e keqe që ndodh në Ballkan, mund të përhapet lehtësisht në të gjithë rajonin. Dhe, ky është sërish rasti, siç konfirmoi ndeshja e futbollit.

Është jashtëzakonisht i rëndësishëm, jo vetëm për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor por për BE-në, fakti se të gjitha vendet e BP kanë dy prioritete të përbashkëta: anëtarësimin në BE dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, dhe pothuajse të gjithë aspirojnë për anëtarësim në NATO.

Dialogu dhe bashkëpunimi është një shtyllë e të ardhmes në BP. Si Shqipëria ashtu dhe Mali i Zi, si gjithë të tjerët, kontribuojnë tërësisht, në pajtimin dhe aspiratat e rajonit drejt anëtarësimit të plotë të çdo vendi në familjen e kombeve europiane. Aspiratat e rajonit drejt anëtarësimit të plotë të çdo vendi në familjen e kombeve europiane. Megjithatë, është e qartë që ne duhet bashkërisht të bëjmë përpjekje shtesë në bashkëpunim me vendet e tjera të rajonit kur bëhet fjalë për zhvillimin ekonomik, duke qenë se marrëdhëniet ekonomike nuk ndjekin marrëdhëniet e shkëlqyera politike. Përveç faktit se është një nga pritshmëritë e Brukselit dhe qendrave të tjera të mëdha politike, ekonomike dhe financiare, ky është

interesi ynë i përbashkët.

Angazhimi dhe fokusi i veçantë i vendeve perëndimore, të kryesuar nga Gjermania, ka një rëndësi kritike për të gjitha vendet e BP. Një tubim historik i kryeministrave të Ballkanit Perëndimor me Kancelaren Angela Merkel u zhvillua në Berlin. Mesazhi kryesor është se, vetëm me bashkëpunim të ndërsjellë ne të gjithë mund të arrijmë përfitime nga zhvillimi, dhe kështu të arrijmë qëllimin - një jetë më e mirë për popullsinë e Ballkanit Perëndimor. U konfirmua se është e një rëndësie vendimtare vazhdimi i nismës sonë të përbashkët: Autostrada Adriatiko-Joniane dhe Gazsjellësi Adriatiko - Jonian. E gjithë kjo më jep të drejtën të them që, me kontributin dhe bashkëpunimin e plotë të të gjitha vendeve të rajonit, dhe nën kujdesin e vendeve të BE, ne jemi duke jetuar një “moment të përshtatshëm” në Ballkan.



### **Arbër Vllahu**

Drejtor Kabineti

Presidenca e Republikës së Kosovës

Jam i nderuar që në emër të Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës të marrë pjesë në këtë konferencë dhe do të doja të shpreh mirënjohjen e thellë për Këshillin Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë për organizimin e saj në një kohë të rëndësishme për zhvillimet në vendet tona dhe në përgjithësi për rajonin e Evropës Juglindore.

Në një kohë kur vlimet politike, në këtë pjesë të Evropës - që ne jemi mësuar ta quajmë Ballkani Perëndimor - po rrezikojnë të rikthejnë retorikat e së kaluarës, që ka lënë aq shumë plagë të pashëruara në shoqëritë tona, është e domosdoshme që të gjejmë forcën për të tejkaluar dallimet tona, duke ndërtuar një tjetër mënyrë të jetesës dhe të bashkëpunimit që përshpejton rrugën e integrimeve tona.

### **Çfarë nënkupton integrimi rajonal:**

**E para**, ka të bëjë me përcëptimin që të tjerët kanë për ne dhe jo ne për vetveten. I konsideruar si a) Rajon i brishtë, b) Rajon i krizave, c) Rajon i dhunës etnike, d) Rajon i pazhvilluar për shkak të mosdurimeve mes vete, e) Rajon i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prandaj kemi një ngecje të madhe të rrugës së integritit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për shkaqe të thella politike, dhe të mundësisë rikthimit në të kaluarën nacionaliste.

**E dyta**, ne kemi problemet tona, si shtete të vecanta të rajonit të Ballkanit, me integrimin fillimisht të qytetarëve tanë në jetën shoqërore e institucionale të vendeve tona. Pavarësisht idesë që po ndërtojmë si shtete qytetare, të njerëzve të barabartë ne po përballemi me problemin e mosbesimit ndërmjet qytetarëve tanë dhe në disa raste edhe të mosdurimit etnik.

**E treta**, jo më pak e rëndësishme, ka të bëjë me stabilitetin dhe sigurinë në rajon, që rrjedh nga stabiliteti i brendshëm i secilit shtet vec e vec në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe që kontribuon edhe në stabilitetin e përgjithshëm.

### **Integrimi rajonal i Ballkanit Perëndimor**

- Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor së bashku, nuk mund të përafrohen në nivelin e GDP të vetëm Hungarisë, që është vendi më i afërt i rajonit tonë.
- Ndërtimi i nivelit të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, pa paragjykime dhe me statute të barabarta.
- Si vende në tranzicion, të cilave po na merr kohë kjo periudhë e transformimit të ekonomive tona nga periudha e tregut të kontrolluar në tregun e lirë, duhet të gjejmë mënyrat e bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, duke ruajtur karakteristikat tona si vende.
- a) Nivelet e bashkëpunimit politik përcaktojnë edhe nivelin e bashkëpunimit ekonomik dhe anasjelltas. Por duke krijuar lehtësi të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor përshpejtohet edhe procesi i integritimeve evropiane.
- b) Kriteret t'i quajmë mbizotëruese për rrugën evropiane duhet të përkthehen në kritere të integritimeve ballkanike:
  1. Stabiliteti politik – që nënkupton ndërtim të marrëdhënieve më të ngushta mes shteteve të Ballkanit Perëndimor
  2. Siguria – që nënkupton edhe stabilitet e paqe për rajonin dhe gjithashtu edhe stabilitet politik
  3. Bashkëpunimi i mekanizmave të sigurisë – për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe trans-border crimes.
  4. Në këtë rrafsh Kosova duhet të përfshihet në të gjitha strukturat rajonale edhe të sigurisë por edhe të bashkëpunimeve të tjera, dhe mbi të gjitha të jetë pjesë e EUROPOL dhe INTERPOL
  5. Fqinjësia e mirë – që nënkupton një proces të rëndësishëm të integritimeve jo vetëm rajonale por edhe evro-atlantike
- Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ka prodhuar marrëveshje konkrete, e të cilat duhet të zbatohen në përpikmëri, është hapi më i madh për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.
  1. Në rrafshin politik – ka ndihmuar në stabilitetin politik në gjithë rajonin e Ballkanit dhe ka ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese edhe në nivele më të larta
  2. Në rrafshin e sigurisë – ka ulur tensionet në Ballkan dhe ka krijuar parakushte për bashkëpunim ndërmjet të gjitha vendeve
  3. Në rrafshin ekonomik – ka ndihmuar në relaksim të marrëdhënieve përbrenda nismës CEFTA duke e inkadruar edhe Kosovën si një pjesë të barabartë
  4. Në bashkëpunimin rajonal – ka ndihmuar në anëtarësimin e Kosovës në një pjesë të madhe të nismave rajonale. Dhe ende duhet punë dhe ndihmë.
- Rajoni duhet të flas me një zë. Sepse integritimet evropiane varen plotësisht nga integritimet ballkanike, nga niveli i bashkëpunimit ndërmjet nesh, nga niveli i zhvillimit ekonomik, nga bashkëpunimi ekonomik, social e kulturor, dhe mbi të gjitha nga vullneti politik yni.
- Nuk ka integritime evropiane pa një relaksim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet vendeve tona.
- BE-ja nuk është vend ku ne i zgjidhim problemet tona por në BE hyjmë vetëm atëherë kur të jemi të gatshëm që të pranojmë se niveli i bashkëpunimit ndërmjet nesh, niveli i kulturës demokratike në vendet tona, niveli i crrënjësjes së dukurive negative, dhe i krimeve në përgjithësi, ka arritur një nivel të rëndësishëm.



### **Stevo Pendarovski**

University American College

Shkup, Maqedoni

Duke krahasuar intensitetin dhe strukturën e bashkëpunimit ndër-rajonal në 15 vitet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP), ky bashkëpunim është larg nga ajo që ne kemi dëshmuar në pjesë të tjera të Europës post-komuniste (Grupit të Vishegradit ose shtetet baltike). E vërteta është se edhe niveli i deritanishëm i bashkëpunimit është arritur për shkak të shtytjeve konstante nga partnerët tanë të BE-së, jo për shkak të përpjekjeve të sigjerta nga ana e elitave rajonale. Ata janë edhe sot akoma më shumë në favor të bashkëpunimit me Gjermani, Itali, Turqi apo SHBA sesa me fqinjët e tyre të drejtpërdrejtë. Për ta shpjeguar më qartë, politikanët lokalë shpesh aplikojnë termin “partneritet strategjik”, kur përshkruajnë marrëdhëniet me shtetet më të fuqishme, duke injoruar pabarazinë në burime dhe faktin se Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP) në total i të gjitha vendeve të BP është më i vogël sesa, për shembull, GDP e Greqisë.

Sipas pikëpamjes sime, dy pika zënë vend të dukshëm si pengesat kryesore për bashkëpunim: së pari, trashëgimia komuniste që për dekada kishte preferuar izolimin, ndërkohë duke mos nxitur shpirtin sipërmarrës të popullit dhe, së dyti, mungesa e besimit për shkak të serisë së luftërave të përgjakshme dhe konflikteve në 1990-ën kur fqinjët u përleshën mbi të njëjtat territore.

Përveç statusit formal të tyre në lidhje me BE-në, rajoni i BP po rrëshqet prapa në vitet e fundit në të gjithë parametrat vitale të demokracisë, kryesisht për shkak se bashkësia ndërkombëtare është vetëm simbolikisht e pranishme dhe rajoni është lënë tërësisht në duart e elitave të brendshme, kredencialet demokratike të të cilëve janë tejet të dobëta.

Kriza në Ukrainë ka acaruar ndasitë ekzistuese në rajon dhe lehtësuar depërtimin më të thellë të Ruisë në Ballkan edhe më shumë se në vitin 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë. Për çudinë e të shumtëve, ajo madje solli përsëri dilemën kryesore të hershme të post-komunizmit: Lindje apo Perëndim? Në BP për vite ne nuk jemi duke ndjekur debatet më të rëndësishme mbi vlerat e demokracisë dhe te drejtave te njeriut, të cilat nuk i kemi shijuar aspak përgjatë dekadave të gjata të komunizmit. Politika nuk

duhet dhe nuk mundet të kufizohet vetëm në bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar. Popujt e Ballkanit Perëndimor dhe partnerët tanë Euro-Atlantikë duhet menjëherë të rivendosin mirëkuptimin e ndërsjellë mbi bazat e demokracisë. Përndryshe, ne do të shohim takoma më shume tendenca autoritare dhe pseudo-demokracitë, qëllimi kryesor i të cilave është që me anë të zgjedhjeve formale të sigurojnë legjitimitetin e jashtëm, në thelb, të regjimeve jo-liberale.



**Dr. Dusan Janjic**

President i Bordit Ekzekutiv

Forumi për Marrëdhënie Etnike

Beograd

Kur mendoj për prioritetin e parë, Serbia po shkëputet nga e kaluara, e traumatizuar nga konfliktet ndër-etnike dhe mosmarrëveshjet, dhe veçanërisht me idenë për të qenë udhëheqës diku në rendin e ri të ditës, që është integrimi euro-atlantik. Ky është prioriteti i parë. Kjo nuk është e mjaftueshme. Në këtë kuadër, është e qartë se sundimi i ligjit dhe forcimi i institucioneve është diçka që duhet të bëhet nga Serbia dhe vendet e tjera. Kur flasim për këtë, ne duhet të dimë se kjo nuk mund të arrihet vetë. Në të kaluarën kemi pasur përfshirjen e shumë aktorëve ndërkombëtarë, si dhe organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të biznesit, si dhe udhëheqës të qeverive dhe vendeve. Por partitë politike nuk kanë detyrën e tyre.

Qeveritë do të ndryshojnë, si në Beograd ashtu edhe në çdo vend tjetër. Si udhëheqës i Partisë Social Demokratike, “*Serbia Active*”, unë do të doja t’ju informoj, dhe jam me të vërtetë i kënaqur dhe i lumtur, që në mars të vitit të ardhshëm do të kemi në Serbi përfaqësuesit e partive Social Demokratike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja, Mali i Zi dhe Serbia, për të diskutuar një çështje – normalizimin e vendeve tona, përfshirë edhe normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës. Cili është qëllimi i këtij takimi? E kemi iniciuar këtë takim dy vjet më parë, dhe nuk është e lehtë. Por unë personalisht kam nxjerrë një mësim nga incidenti gjatë ndeshjes së futbollit midis Shqipërisë dhe Serbisë në Beograd: ne duhet të bëjmë punën tonë, si parti politike dhe udhëheqësit e tyre, ashtu edhe udhëheqësit e tjerë. Për këtë, unë jam me të vërtetë i lumtur për vizitën e Kryeministrit Rama në Beograd. Ne po organizojmë një tryezë të rrumbullakët mbi bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Serbisë, e cila do të jetë një mundësi për të përfituar më shumë nga vizita e kryeministrit Rama. Vizita nuk është vetëm historike, si vizitë në vetvete. Ne e dimë shumë mirë që Z. Ilir Meta dhe Presidenti Meidani janë përpjekur shumë për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Por kjo vizitë po ndodh gjatë mandatit Rama. Por ne duam që kjo vizitë të kenë më shumë efekt publik. Ky takim do të jetë në thelb mundësi jo vetëm për



kryeministrin Rama, por edhe për përfaqësues të biznesit nga Serbia, liderë politikë, deputetë, organizata të shoqërisë civile, si dhe diplomatë, për të diskutuar mbi atë që Serbia dhe Shqipëria mund të bëjmë më mirë për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre dypalëshe.

Përsa i përket ekonomisë, duhet të them se burokracia evropiane po përballet me realitetin. Ndoshta për shkak të presionit që vjen nga poshtë, ndoshta ka disa ndryshime në mandatin e fundit të Merkel, në Berlin. Unë do t'ju them se pse e dua Gjermaninë në dy vitet e fundit, për shkak se ata kanë përdorur të ashtu-quajturën „lista e çfarë duhet bërë”<sup>4</sup>. Dhe deri më sot ata kanë përdorur listën e verifikimit - çfarë është zbatuar nga premtimet. Kjo është diçka që ne kemi nevojë. Unë mendoj dhe shpresoj se kjo politikë do të mbështetet edhe nga përfaqësuesit italianë. Është me të vërtetë një moment i mirë që gjermanët dhe italianët janë të përfshirë. Ata na njohin, dhe ata duhet të përdorin këtë mundësi, por ju lutem mos bëni një gabim - atë të bërë nga Ashton - mos prodhoni më shumë bashkëpunim sesa ne mund të konsumojnë. I referohem këtu Kosovës, Serbisë dhe kështu me radhë, si dhe kroatëve. Por për stabilitetin dhe për bashkëpunimin më të mirë të Ballkanit Perëndimor, është e nevojshme normalizimi i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Shqipërisë.

Modeli i Benelux-it është një model i mirë për bashkëpunim ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Por ky model nuk u krijua mbështetur tek politika. Ai u ndërtua mbi çështjen e energjisë. Energjia dhe mjedisi përbëjnë fillimin e bashkëpunimit tonë, plus infrastruktura.

Së fundi, jam i dhënë pas Gjermanisë, sepse ata iniciojnë dhe përfundojnë diçka. Ne kemi regjistruar të gjitha projektet që janë të rëndësishme për bashkëpunimin mes vendeve të rajonit, duke filluar me Serbinë dhe Kosovën. Për të qenë të saktë, në thelb bashkëpunimi i parë është ai mbi burimet ekzistuese. Ne kemi potencialet ujore dhe mund ta përdorim për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet tona ekzistuese. Një tjetër mundësi e të ardhmes është bashkëpunimi në sektorin e gazit. Z. Meta përmendi Gazsjellësim Trans-Atlantik, që është një nismë e mirë e bashkëpunimit. Por ky projekt nuk përfshin Serbinë. Është edhe çështja e Bosnjës. Ne kemi nevojë për diversifikim, dhe kemi nevojë për më shumë infrastruktura duke përfshirë edhe atë të gazifikimit.

Gjithsesi, unë mendoj se ne mund të fillojë nga niveli bazë i ekonomisë, me privatizimin e kompanive të energjisë, në të gjitha kryeqytetet. Por qeveritë duhet të insistojnë në ekonomi, dhe në burimet e energjisë që ne tashmë kanë, në mënyrë që të arrijmë me lehtësi përmbytjen e interesave tona të përbashkëta. Dhe unë do të përfundoj duke cituar Edita Tahiri, gjatë Konferencës Aspen “se pse Kosova duhet të blejë energji, kur Kosova mund të eksportojë energji”. Do të thotë ne kemi shkaktuar ndërvarësinë midis vendeve.

Njohja e Kosovës është pjesë e rendit të ditës. Nëse politikanët këmbëngulin në të kaluarën, kjo është çështje vendimtare. Nëse ata shikëputen prej saj dhe shohin drejt së ardhmes që do të ishte akti i parë, njohja e Kosovës është diçka që duhet të bëhet në fillim ose në afërsi të fillimit të anëtarësimit të Serbisë dhe Kosovës në Bashkimin Evropian. Dhe për këtë, në diskutimet tona të brendshme serbe është me të vërtetë jo-inteligjente shprehja se ne kurrë nuk do ta njohim Kosovën. Ministri Hoxhaj ka kontakte shumë të mira dypalëshe me ministrin Daçiç. Dhe kjo po funksionon ngadalë. Përvoja e mirë e marrëveshjes midis dy Gjermanive është një shembull i mirë. Ne duhet të mësojmë nga të tjerët, por ne gjithashtu duhet të respektojmë situatën specifike në vendet tona. Por një gjë është e sigurtë. Pa bashkëpunimin rajonal ne jemi askush nga askund. Nëse duam të arrijmë diçka, ne duhet të punojmë së bashku në fushat ku mund të bashkëpunojmë në bazë të respektit dhe interesit të të gjithë partnerëve.



### **Srdjan Dizdarevic**

Human Rights House

Sarajevo

### **Shoqëria civile si aktor i rëndësishëm për Integrimin Evropian**

Aktorët e shoqërisë civile, organizatat jo-qeveritare në radhë të parë, janë përballur me situata dhe sfida të ndryshme në varësi të vendit ku ata punojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Shqipëri, Maqedoni. Megjithatë, ata kanë të përbashkët faktin që filluan të trajtojnë çështje të tilla si demokratizimi, të drejtat e njeriut, sundimit të ligjit vetëm pas viteve 90, pas rënies së regjimeve një-partiake. Si relativisht të rinj, ata duhej të përballeshin me tranzicionin në ekonominë e tregut dhe demokracinë, procesin e dhimbshëm të promovimit të të drejtave të njeriut dhe luftën kundër korrupsionit, e cila ishte gjithashtu diçka që ata ishin duke përjetuar. Përveç kësaj, disa nga këto vende kanë pasur një rrugë të vështirë nga lufta drejt paqes me çështjet e drejtësisë, pajtimit ...

Megjithatë, organizatat jo-qeveritare ishin aktorët e para të rëndësishëm që në mënyrë të qartë artikulojnë idenë e paqes, të marrëdhënieve paqësore në rajon; ato kanë vendosur kontakte dhe bashkëpunim gjatë kohës kur ushtritë e tyre ishin duke luftuar ashpër kundër njeri-tjetrit duke kryer krime nga më të rëndat të mundshme, përfshirë krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Në këtë mënyrë, ata në thelb e kanë parashikuar bashkëpunimin rajonal dhe karakterin e tij. Dialogu Civil ndërmjet OJQ-ve nga Serbia dhe Kosova në kohën e konfliktit të armatosur është një shembull. Tjetër mund të jetë Iniciativa Igman, ndërmjet Bosnjë dhe Hercegovinës, Serbisë, Malit të Zi dhe Kroacisë; në këtë kontekst, aktivistët nga Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi ishin duke vizituar Sarajevën gjatë rrethimit të kryeqytetit boshnjak duke dhënë një mesazh të qartë se bashkëpunimi paqësor është i mundshëm. Shumë iniciativa të tjera ilustrojnë gjithashtu rolin e aktorëve të shoqërisë civile si paraardhës të asaj që ne kemi sot si bashkëpunim në rajon.

Organizatat jo-qeveritare në rajon janë duke promovuar, në nivel kombëtar por edhe në atë ndërkombëtar, parimin e dialogut ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve, proceset konsultative. Në thelb, ata janë duke promovuar parimet që ekzistojnë në marrëveshjen e Lisbonës, neni 11, që rregullon këtë

çështje brenda BE. Në të njëjtën kohë, qytetarët dhe OJQ-të janë sinqerisht në favor të vlerave evropiane dhe ato janë seriozisht duke promovuar reformat pro-evropiane dhe idenë e bashkimit të BE, çka nuk mund ta themi për autoritetet zyrtare të disa prej vendeve që preferojnë mungesën e sundimit të ligjit në mënyrë që të bëjë atë çfarë bëjnë në mungese të ndëshkimit

BE-ja duhet të vendose një strategji për secilin vend në rajon, duhet të deklarojë qartë se të gjitha vendet evropiane që kanë arritur standardet e BE janë të mirëpritur si anëtarë të ardhshëm. Në të njëjtën kohë, BE-ja duhet të mbështesë lëvizjen e vërtetë pro-evropiane të shoqërisë civile në secilin prej vendeve, pavarësisht qëndrimeve të autoriteteve lokale ndaj aktorëve të shoqërisë civile. Vetëm këto përpjekje të dyfishta mund të vlerësojnë dhe të “evropianizojnë” rajonin duke nënkuptuar gjithashtu, stabilitetin të përhershëm dhe paqen në rajon.

## Gjetjet Kryesore të Panelit të Parë

- ❖ Momenti i duhur për organizimin e një konference të tillë rajonale për Ballkanin Perëndimor.
- ❖ Momenti i duhur për të nxitur bashkëpunim më të madh ekonomik ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Ndërlidhja-elementi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërive. Përmirësimi i infrastrukturave rajonale sjell më pranë vendet e Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Shkëmbimi i njohurive me qëllim posedimin e njohurive për bashkëpunim, lëvizshmëria e dijeve, që do të mundësohet nga rrjetet e ekselencës, shkëmbimi i njohurive më të avancuara, etj.
- ❖ Përbushja e kriterëve të anëtarësimit të BE-së dhe mbi të gjitha fuqizimi i shtetit të së drejtës, si kriteri më i rëndësishëm për arritjen e objektivave të tjerë.
- ❖ Nevoja për mbështetjen e lëvizjeve civile pro-europiane.
- ❖ Stabiliteti dhe siguria në rajon e ka origjinën nga stabiliteti dhe siguria e brendshme e vendeve, duke gjeneruar në këtë mënyrë një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurtë të Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Integrimi European i Ballkanit Perëndimor mbetet e vetmja alternativë për vendet e këtij rajoni.
- ❖ Rëndësia e dialogut Kosovë-Serbi për stabilitetin, sigurinë, bashkëpunimin ekonomik dhe rajonal të Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar mes vendeve të Ballkanit Perëndimor është i nevojshëm.
- ❖ Elitat politike të Ballkanit Perëndimor duhet të monitorohen aktivisht nga qytetarët dhe komuniteti ndërkombëtar me qëllim që të distancohen nga tendencat autoritariste të regjimeve jo-liberale.
- ❖ Fryma e bashkëpunimit mes vendeve të rajonit duhet të fillojë nga partitë politike.
- ❖ Bashkëpunimi mes vendeve të BP është më i mirë me vendet e fuqishme sesa mes njëri-tjetrit.
- ❖ Mungesa e përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar për të kundër-balancuar/dobësuar dorën e fortë të elitave të brendshme me kredenciale të dobëta.

❖ *Panel: Shteti i së Drejtës dhe Rritja Ekonomike si kritere themelore për Integrim*

*Moderator – Profesor Arben Malaj*



**Profesor Abdylmenaf Bexheti, Maqedoni**

Anëtar i Akademisë së Shkencave, Maqedoni

Të nderuar pjesëmarës,

Fillimisht falënderoj Presidentin e Këshillit Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë, ambasadorin Agim Nesho, si dhe Drejtorin e Friedrich Ebert Stiftung, z. Hantke, për ftesën e bërë në këtë konferencë shumë të rëndësishme rajonale. Njëheri shfrytëzoj rastin të përshëndes të gjithë pjesëmarësit në konferencë, posaçërisht përfaqësuesit diplomatik dhe misioneve të ndryshme në Shqipëri si dhe mediumet prezente.

I vetëdijshëm për kohën e shkurtër në dispozicion, pa një hyrje të përgjithësuar për bashkëpunimin ekonomik rajonal, dua të fokusohem në çështje konkrete dhe të ngre vetëm dy pyetje për trajtim, njëra prej të cilave, edhe pse konvencionale, për nga trendi pwrkeqësues është brengosës për bashkëpunimin ekonomik rajonal.

**1. Çështja e parë ka të bëjë me Indikatorët bazik të bashkëpunimit rajonal më konvencionalë-shkëmbimin tregtar dhe investimet reciproke**, edhe atë në trekëndëshin Maqedoni-Shqipëri-Kosovë por edhe në qasjen bilaterale.

**Maqedoni-Shqipëri:** Nga viti 2008 kur “arrihet kulmi” i eksportit me 107 mil.\$ dhe importi me 36m.\$, trendi befasisht është rënë me reth 20-25%, në vend që të ishte së paku me ato përmasa rritëse. Sot, përfundimisht me shënimet e muajit Gusht 2014, gjendja është 34,7 m.\$ eksport dhe 21,4 m.\$ import.

Ndërkohë që investimet e huaja direkte nga Shqipëria në Maqedoni, nga v.2010-2013, mesatarisht shkojnë në reth 38 mil.\$ në vit por jo edhe nga Maqedonia në Shqipëri.

Arsyet mund të jenë të natyrave të ndryshme, zakonisht, ato të korpusit të faktorëve ekonomik duhet të jenë pro një tendence pozitive duke patur parasysh një përmirësim relativ të infrastrukturës (së paku

rrugore nga ana e Shqipërisë), por edhe tregje gjeografikisht shumë të afërta, me një nivel të përafërt të zhvillimit ekonomik dhe me një shkallë relativisht të mirë të komplementaritetit sektorial. Do ishte keq po të kishin ndikuar negativisht më shumë faktorë të tjerë. Vetëm periudha është indikative!

Në këto rethana, duhet inicuar, përkrahur dhe motivuar bashkëpunimi i asociacioneve të biznesit (B2B), ti sjellim në një tavolinë ata dhe vetë le të gjejnë format dhe mundësitë më të mira të bashkëpunimit. Qeveritë duhet domosdo të jenë proaktive në këtë drejtim. Sa më parë një plan veprimi dhe harmonizimi të dinamikës për infrastrukturën e Korridorit 8, për të cilin ekziston vetëm përcaktim deklarativ dhe më së paku është bërë veprim konkret, posaçërisht këtu ngec Maqedonia. Iniciativa “Merkel” mund të ndihmojë shumë këtu.

**Në këtë çështje situata është edhe më keq me Kosovën!** Vetëm për tre (3) vitet e fundit, shkëmbimi tregtar është përgjysmuar - nga 541 mil\$ eksport në vitin 2011 në 276 mil.\$ në vitin 2013! Ndërkohë që importi qëndron në të njëjtat nivele, në rreth 30 mil\$ - Suficiti më i lartë që ka Maqedonia në shkëmbim tregtar me botën e jashtme. Arsytet janë të ndryshme, por gjithsesi ndikim të dukshëm do ketë edhe Marrëveshja politike midis Kosovës dhe Serbisë. Ky trend do vazhdojë të përkeqësohet në dëm të ekonomisë maqedonase.

2. Çështja e dytë që desha ta parashtroj janë nevojat për **harmonizim të politikave ekonomike të vendeve në rajon**. “Kopjimi” i tyre më shumë duket si përpjekje për konkurrencë në kapje të avantazhit karshi investitorëve të huaj se sa për krijim të sinergjisë në tregjet tona të fragmentarizuara. Një qasje e konkurrencës në bashkëpunim (*Coopetition-Coopetition in cooperation*) do ishte forma më produktive në këtë drejtim. “Ekuidistanca” e shanseve ekonomike me të gjithë fqinjët po ashtu do ndihmonte kthimin e trendeve në kahe pozitive.

Format e krijimit të institucioneve rajonale si Dhomat ekonomiko-tregtare rajonale, Berza rajonale apo një “Agjenci” rajonale për qasje te Fondet e përbashkëta (me theks në bashkëpunimet ndërkufitare dhe në sektorin e Ambientit apo Energjetik), gjithashtu mund të ishte më produktive sesa qasjet divergjente. Konvergencat rajonale do ishin më produktive në përhithjen e fondeve se sa divergjencat aktuale.

Konferencat e tilla rajonale domosdo që japin kontributin e tyre në këtë aspekt.





**Prof. Dr. Adrian Civici**

President

Universiteti European i Tiranës

***Efektiviteti i funksionimit të hapësirës së përbashkët ekonomike shqiptare***

Iniciativa për krijimin ose efijencën e një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan mishëron një kërkesë evidente në periudhën apo stadin ku ndodhen veçanërisht ekonomitë e Shqipërisë dhe Kosovës. Sot po evidentohet si domosdoshmëri krijimi i hapësirave më të mëdha të veprimit të aktivitetit ekonomik e financiar, të hapësirave jo vetëm territoriale, por dhe njerëzore, kapitaleve, investimeve, tregtisë, shërbimeve, etj. Në këtë këndvështrim, edhe *ideja e nxitjes së një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan mund të vlerësohet si një hap prej kërkimit të rritjes së rëndësisë dhe prej frymëmarrjes së sistemit ekonomik e financiar, të tregjeve e të shkëmbimeve të të gjitha llojeve për ekonominë shqiptare, atë kosovare dhe pse jo, edhe për atë të disa vendeve të tjera të Europës jug-lindore si Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, etj. Larg ideve ose praktikave të nacionalizmit ekonomik e politik, ajo që synohet janë analizat, studimet dhe propozimet konkrete për masa, për politika ekonomike, për strategji zhvillimi ekonomik, për realizim të projekteve me inpakt të konsiderueshëm, për thithje të drejtpërdrejtë investimesh të huaja, rritja e efijencës së mjaft investimeve të realizuara deri tani, koordinimi më i mirë i interesave dhe i sferës së veprimit të biznesit privat, shfrytëzimi i avantazheve krahasuese të njëri-tjetrit, koordinimin e politikave tregtare dhe tregtinë reciproke, koordinimin e politikave energjitike, bashkëpunimin e dhomave të tregtisë e të industrisë, etj.*

Zgjerimi dhe mirëfunksionimi i një tregu ballkanik në përgjithësi dhe në këtë kuadër edhe atij mbarëshqiptar në veçanti do të ishte një hap më shumë drejt integritimit european. Për më tepër, një nga sfidat e sotme të globalizimit është sfida e integritimit të ekonomive të vendeve të ndryshme me njëra-tjetrën, është shkalla e hapjes së tyre ndaj ekonomisë globale, është përballimi i konkurrencës ndërkombëtare, që sa vjen e bëhet më e vështirë nëse ekonomitë e vendeve të ndryshme ose tregjet janë të vogla e të izoluara. Pikërisht për këtë arsye ne duhet të kërkojmë dhe të përpiqemi

që ta zgjerojmë hapësirën bashkëpunuese dhe ndërvarësinë e ekonomive tona, jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por në gjithë hapësirën ballkanike.

Masat ose politikat që mund të ndërmerren janë të shumta. Si të tilla mund të përmendim : thellimin e diapazonit të veprimit dhe të efektit të marrëveshjeve tregtare dhe këmbimit të mallrave ose shërbimeve; përdorimi i burimeve dhe faktorëve të prodhimit mbi baza komplementare mes vendeve; hartimi dhe koordinimi i projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me transportin, kryesisht atë rrugor e hekurudhor; koordinimi i politikave dhe investimeve në energjetikë aq më tepër që , mund të jemi komplementarë në prodhimin e energjisë; përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe heqjes së barrierave të panevojshme administrative me qëllim lehtësimin e procedurave për shkëmbimin e mallrave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit mes vendeve; përfshirjen e përbashkët në programet europiane e ndërkombëtare; harmonizimi i ofertës dhe i produkteve turistike cilësore për t'u bërë një pol i rëndësishëm turistik rajonal; koordinimi i politikave makroekonomike, fiskale e buxhetore për të krijuar një zonë ekonomiko-financiare të përbashkët, të stabilizuar dhe larg krizave; hartimin dhe implementimin e politikave të përbashkëta për përmirësimin e klimës së biznesit dhe për stimulimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme; nxitjen e bashkëpunimit të dhomave të tregtisë dhe industrisë për koordinimin e biznesit privat që është një faktor fundamental për ekonominë tona; bashkëveprimi më i mirë i tregjeve financiare dhe bankave; koordinimi ligjor e institucional për luftimin e krimit financiar e ekonomik, pastrimin e parave, eliminimin ose zbulimin e transaksioneve ose pagesave jolegale, etj., mund të vlerësohet si një drejtim i rëndësishëm integrimi financiar i rajonit.



### **Dr. Zef Preçi**

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

Që nga rënia e Murit të Berlinit, vendet e Ballkanit Perëndimor janë pozicionuar drejt ekonomive të tregut dhe fuqizimit të demokracisë, përmes disa skemave të ngjashme të formave transformuese, të tilla si privatizimi i pronësisë publike, liberalizimi i tregut, liberalizimi i çmimeve, hapjen ndaj investimeve të reja, duke kontribuar kështu në ndërtimin e institucioneve të ekonomisë së tregut. Çështja më shqetësuese për vendet e Ballkanit Perëndimor është funksionimi i këtyre institucioneve, që rezulton nga arritjet por edhe nga gabimet e secilit vend të rajonit, i cili qëndron në nivele të ndryshme në integrimin Euro-Atlantik dhe integrimin rajonal.

Përsa i përket bashkëpunimit rajonal, ekzistojnë shumë iniciativa – ndonjëhere mikluese, të vazhdueshme, ose ato të reja, - që synojnë arritjen e këtij bashkëpunimi. Forma më e suksesshme e bashkëpunimit në sektorin ekonomik është ajo e Jugo-sferës. Bashkëpunimi mes vendeve të ish-Jugosllavisë ka funksionuar shumë më mirë sesa CEFTA, apo forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik, për shkak të marrëdhënieve tregtare, njohjes së ndërsjellë, por mbi të gjitha në nivelin e transaksioneve të aktivizuara nga kjo formë e organizimit. Përsa i përket bashkëpunimit rajonal, iniciativave të ndryshme rajonale iu mungojnë mekanizmat për zbatimin e tyre. Një vullnet i shprehur politik nuk materializohet më tej dhe mbetet në vullnetin e individëve.

Diplomacia ekonomike është një tjetër aspekt, të cilës i është dhënë mjaft konsideratë dhe fokus nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në vitet e fundit, me qëllim njohjen e vendit, strukturës së saj ligjore dhe institucionale dhe mundësive për të rritur tregtinë dhe bashkëpunimin. Megjithatë vendet tona vazhdojnë të jenë të varura nga qendrat evropiane të tilla si Roma, Brukseli, Berlina etj. Në thelb, nuk i është transmetuar ende qytetarëve mesazhi se procesi i integritimit në BE vendoset në vendet tona dhe jo në Bruksel. Kjo kushtëzon përmbushjen e kriterëve të vendosura nga BE, për fuqizimin e shtetit të së drejtës.

Bashkëpunimi rajonal, si modeli i Beneluksit, është një nga mënyrat që i shërben përsheptimit të integritimit në BE. Çdo hap drejt bashkëpunimit më të ngushtë rajonal kontribuon në integrimin e rajonit në tërësi në Bashkimin Evropian.

Shumë vëmendje i është kushtuar ndërtimit të infrastrukturës - rrugëve, porteve, aeroporteve, impianteve hidro-energjitike, etj, - por struktura ligjore ende vuan nga politika e koordinimit dhe bashkëpunimit, modelet që do të përdoren etj, duke përfshirë rregullimin e tregut dhe konkurrencën. Ka një tendencë, e përmendur gjithashtu edhe nga folësit e tjerë që mafia, oligarkia, lobet ekonomike, etj, janë më të interesuar për bashkëpunim dhe funksionimin më të mirë, dhe industria përpiqet të kontrollojë subjektet rregullatore duke mbajtur në këto vende nivelin e ulët të konkurrencës. Indeksi i të bërit biznes, tregon përmirësime, ndërsa indeksi i konkurrueshmërisë paraqet një vlerësim më real dhe i gjithë rajoni po përballlet me probleme serioze në lidhje me tregjet e kontrollit dhe një funksionim të përshtatshëm të enteve rregullatore.

Në një kontekst më të ngushtë, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova brenda rajonit mund të bashkëpunojnë shumë më mirë përmes ndarjes së përvojave dhe të burimeve njerëzore, duke përdorur avantazhet e tyre krahasuese - të infrastrukturës energjetike, porteve, aeroporteve, etj, përmes projekteve të përbashkëta, publike, private ose publiko-private për investime. Nga ana tjetër, siç u përmend, krijimi i zyrave koordinuese do të mundësojë koordinim nëpërmjet njohjes dhe koordinimin e politikave, që mund të çojë në përdorimin efektiv të burimeve të mundshme të këtyre vendeve. Duke vënë theksin në avantazhet krahasuese dhe konkurruese të çdo vendi si baza për rritjen e konkurrueshmërisë së secilit vend në veçanti dhe të rajonit në tërësi, do të arrihej konvergjenca ekonomike.

Së fundi, ndërtimi i besimit të ndërsjellë midis vendeve të rajonit, në nivelin bazë, të biznesit, tregtisë dhe nivelit të investimit, do të kontribuojë në ndërtimin e besimit në nivel politik. Në këtë mënyrë, deviza e zhvillimit të ardhshëm, mendoj se do të jetë nxitja e lirisë së lëvizjes së popujve, kulturave, mallrave dhe kapitaleve.



### Profesor Arben Malaj

President, Instituti për Politika Publike dhe Qeverisje të Mirë

#### Disa Ide

- **BE – është projekti që inspiron**, është projekti, që nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritit ekonomik, “armiqtë” u bënë partnerë për të eliminuar konfliktet dhe luftrat, dhe për të mbështetur paqen dhe prosperitetin.
- **BE e ka arritur misionin fisnik të eleminimit të** luftrave dhe konflikteve. Ballkani Perëndimor ka vuajtuar nga konfliktet deri në vitet 2000.
- Historia e sukseshme e BE-së - **një road-map** për vendet e Ballkanit Perëndimor.
- **Bashkëpunimi në nivel rajonal - parakusht për të testuar e parapërgatitur** ekonomitë e Ballkanit, për tu ballafaquar me hapje më të madhe dhe më konkurruese.
- **BE e filloi bashkëpunimin nga sektori strategjik-energji**. Koncepti i sektorit strategjik duhet të orientojë edhe prioritetin e bashkëpunimit në nivel rajonal.
- **Thellimi i të katër lirive ekonomike** në qendër të bashkëpunimit ekonomik.
- **Politikat ekonomike të bazuara në patriotizëm apo nacionalizëm** kanë rezultuar të dëmshme. Ka pasur pengesa/luftra tregtare për mallrat e ndryshme midis Shqipërisë dhe Kosovës, midis Serbisë – Maqedonisë, Kosovës dhe Maqedonisë, etj.
- **Bashkëpunimi rajonal duhet të bazohet në** strategji rajonale afatmesme dhe afatgjata ku duhet të optimizohen dhe harmonizohen prioritetet e vendeve të vecanta me prioritetet me impakt rajonal, ku efekti *spill-over* bëhet më i madh për të gjithë.
- Ky vision dhe angazhim lehtëson edhe mbështetjen nga politikat dhe fondet e BE-së dhe institucioneve financiare të saj.

- **Thellimi i bashkëpunimit dhe konkretizimi real i integritit rajonal dhe european** kërkon (i) vizion; (ii) strategji dhe (iii) institucionet përkatëse në nivel rajonal.
- Institucionet e BE-së, embrionet e Këshillit European dhe Këshillit të Ministrave, e Komisionit European dhe Parlamentit European, **lindën bashkë me projektin e BE-së dhe janë përgjegjëse për suksesin e projektit.**
- **Ballkani akoma nuk ka krijuar asnjë prej këtyre insitucioneve**, ndaj procesi pengohet nga spontaniteti. Ka shumë projekt-ide, shumë takime, shumë deklarata por pak projekte rajonale të sukseshme.
- Schuman, në deklaratën e 9 Maj 1950, qartësoi se BE nuk do të bëhet sipas një plani të vetëm dhe brenda një date. Ajo **do të mbështetet tek sukseset që do të krijojnë solidaritetin *de facto*.**
- Ballkani akoma nuk po prodhon një sukses konkret në bashkpunimin rajonal. **Ndodhemi në sfidën e zgjerimeve, që po na ngushtojnë.** Pas cdo zgjerimi, BE-ja bëhet më e madhe. Pas çdo zgjerimi, pjesa e mbetur e Ballkanit bëhet gjithnjë e më e vogël.
- **Sfidat e Ballkanit** – eliminimi i vonesave, eliminimi i mentaliteteve, politikave dhe qëndrimeve proteksionisto-nacionaliste.



## Gjetjet Kryesore të Panelit të Dytë

- ❖ Lidhja e ngushtë mes shtetit ligjor dhe rritjes ekonomike. Lufta kundër korrupsionit, informalitetit ekonomik, etj, zvogëlon kostot e transaksionit dhe rrit efikasitetin e investimeve. Forcimi i shtetit të së drejtës përmes reduktimit të kostove të transaksioneve ndikon në krijimin e kushteve bazë për zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike, duke mundësuar afrimin me vendet e BE dhe integrimin në BE.
- ❖ Lidhja e fortë midis zhvillimit ekonomik dhe vullnetit politik. Nevoja për të ndërtuar besimin reciprok midis vendeve të rajonit në nivelin bazë, ekonomik dhe investimeve do të çojë në ndërtimin e besimit në nivelin politik.
- ❖ Mungesa e ndërlidhjes midis vendeve të rajonit. Nevoja për krijimin e një modeli të modelit Ballkanik në bashkëpunimin ekonomik. Ballkani kërkon dhe është në gjendje të krijojë një qendër të vetën në mënyrë që të jetë në gjendje të lidhet me qendrat e tjera, të tilla si Bashkimi Evropian.
- ❖ Nevoja për konvergjencë ekonomike ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në nivelin e politikave të zhvillimit. Integrimi European duhet të konsiderohet jo si një aneks por si si një mekanizëm plotësues për zhvillimin ekonomik
- ❖ Mjaftueshmëria e marrëveshjes së CEFTA-s *kundrejt* nevojës për një bashkëpunim më të thellë ekonomik.
- ❖ Nismat Rajonale nga vendet e huaja, si Konferenca e Berlinit e Ballkanit Perëndimor, janë gurë të rëndësishëm themeli lidhur me vullnetin politik për forcimin e bashkëpunimit rajonal mes Ballkanit Perëndimor. Por këto iniciativa dështojnë për tu materializuar pasi mbeten në dorë të vullnetit të individëve.
- ❖ Diplomacia ekonomike - një mjet i fuqishëm për tu përdorur në funksion të rritjen së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.
- ❖ Nivel i lartë i ndërvarësisë nga vendet kryesore ekonomike. Vendet e Ballkanit duhet të punojnë shumë për të përmbushur kriteret e BE, për t'iu afruar integritit të tyre evropian.
- ❖ Nivelin e ulët i konkurrencës për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, për shkak të kontrollit mbi tregjet dhe nivelit të funksionimit të enteve rregullatore.
- ❖ Konvergjenca ekonomike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor do të arrihet përmes vënies në dukje të avantazheve konkurruese dhe krahasuese të secilit vend, duke rritur konkurrencën e vetë atyre, në veçanti, si dhe atë të rajonit në përgjithësi.

❖ *Panel - Shoqëria Civile si një aktor i rëndësishëm në Integrimin Evropian*

*Moderator – Arben Malaj*

**Elvina Jusufaj**

Këshilli Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë

Tema e integrimit rajonal gjithmonë ka qenë tërheqëse për shoqërinë civile gjatë tranzicionit demokratik. Shoqëria ballkanike ka arritur në një stad zhvillimi që e shikon integrimin evropian si një domosdoshmëri jo vetëm për standardin e jetesës dhe zhvillimit, por edhe si një mjet për të konsoliduar dhe zgjidhur dilemën që na ka shoqëruar se kujt qytetërimi i përkasim, dhe çfarë zgjedhje duhet të bëjmë. Problemet e vjetra historike, të mbartura në kohë, e vonojnë këtë zhvillim, për më tepër që në Ballkan vazhdojnë ndarjet dhe mosbesimi për atë që mund të realizojmë së bashku. Nga ana tjetër, tranzicioni demokratik i tejzgatur ka sjellë si rezultat që stabiliteti të prevalojë ndaj konsolidimit të demokracisë funksionale, forcimit të shtetit të së drejtës dhe shoqërisë së lirë. Vonesa në procesin e integrimit duket se përkon me interesat e klasave politike për të ruajtur status-quo-në.

Për integrimin evropian gjithmonë e më tepër po bëhet një domosdoshmëri: domosdoshmëri për të forcuar shtetin e së drejtës, domosdoshmëri për luftën kundër korrupsionit që po gërryen gjithmonë e më tepër institucionet e shtetit, domosdoshmëri për të krijuar hapësira të lira të komunikimit të njerëzve, ideve dhe mallrave në hapësirat tona të përbashkëta.

Iniciativa e Kancelares Merkel dhe Konferenca e Berlinit është një shtysë e re për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt Europës. Ky integrim sigurisht do të realizohet në radhë të parë nga një bashkëpunim efektiv në fushën e projekteve ballkanike, investimeve rajonale që do të afrojnë më shumë vendet tona. Pa integrim ballkanik nuk ka integrim evropian. Këto projekte të përbashkëta sigurisht do të na ofrojnë më tepër me njëri-tjetrin dhe do të na përgatisin për të ardhmen më mirë.

Po roli i shoqërisë civile si duhet të jetë? A do të vazhdojmë të qëndrojmë si pjesë e emocioneve të politikës ballkanike apo do të marrim rolin e avokatit/oponentit për të promovuar integrimin në nivelin e shoqërisë civile në të gjithë rajonin tonë?

Për këtë qëllim është e nevojshme që rrjeti i organizatave të shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor të shtrihet dhe forcohet gjithmonë e më tepër. Shoqëria civile mund të shtrijë komunikimin e saj, jo vetëm me projekte dhe konferenca të përbashkëta, por edhe të forcojë prezencën e saj me ide evropianiste në rrjete sociale. Ajo duhet të parandalojë nxitjet etnike, destabilitetin nga forcat ekstremiste dhe duhet të marrë leadershipin në çështjet e integrimit të vendeve të rajonit në Europë. Ajo duhet të përpiqet të realizojë atë që institucionet shtetërore e kanë të vështirë për ta realizuar – zhdukjen e kufijve ideologjikë, nacionalizmin dhe të luftojë për hapjen e shoqërisë, rritjen e llogaridhënies nga qeveritë.

Por shoqëria civile nuk mund të luajë këtë rol e vetme. Vendet tona akoma nuk ndejnë rëndësinë e veprimtarisë së saj. Për më tepër, shoqëria civile duhet të mos shihet si shtojcë e pushtetit. Fondet ndaj shoqërisë civile janë të pakta dhe në shumë raste veprohet në mënyrë klienteliste. Kjo përqsasje duhet të ndryshojë.

Në të njëjtën kohë, projekti evropian kërkon një vëmendje të veçantë ndaj shoqërisë civile. Ndihma e jashtëzakonshme e komunitetit ndërkombëtar për të krijuar institucionet e shoqërisë civile tashmë duket si punë e mbaruar. Projektet po zhvillohen në fusha të tilla në ndihmë të minoriteteve, romëve, shtresave vulnerabël të popullsisë, etj. Në qoftë se kërkojmë të ruajmë forcën e shoqërisë civile ajo duhet përkrahur fuqimisht. Kjo do të realizojë forcimin e një vektori të rëndësishëm që do të shtyjë përpara problemet tona të integritit.

Procesi i integritit evropian është një proces gjithëpërfshirës dhe kërkon pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë civile. Në shumë raste, detyra e konsultimit me shoqërinë civile kalon nëpërmjet selektivitetit ose organizatave që qëndrojnë me pushtetin e radhës. Në kushtet e tranzicionit, fatkeqësisht, shoqëria civile në disa raste u nda sipas interesave politike, gjë që dëmtoi funksionimin e saj si një fuqi horizontale e kontrollit të institucioneve demokratike. Një nga detyrat kryesore të shoqërisë civile për të rritur rolin e saj është rikthimi i pavarësisë së shumë prej organizatave dhe afiliimit të tyre ndaj forcave politike të caktuara. Edhe në rastin e integritit evropian, në shumë raste ky konsultim është bërë në mënyrë klienteliste duke mos përfshirë mendimin më të gjerë, të pavarur, që shpreh më mirë nevojat dhe funksionimin e shoqërisë civile në mënyrë të pavarur.

Detyrë e rëndësishme në procesin e integritit evropian është bashkëveprimi rajonal i shoqërisë civile, jashtë axhendave të imponuara nga institucionet shtetërore të shteteve. Temat e diskutimit, problemet e rëndësishme që shërbejnë për përgatitjen e shoqërisë drejt stadi të integritit evropian nuk duhet të përcaktohen nga interesat e shteteve por nga interesat e vetë shoqërive. Shoqëria civile e vendeve të rajonit tonë duhet të fokusohet më shumë në temat madhore të harmonisë ndëretnike, demokracisë funksionale, barazisë gjinore, të drejtave të minoriteteve dhe gjithë problemeve të tjera që shoqëria ballkanase duhet ti tejkalojë për të bërë të mundur integritin e saj drejt Europës.

## Z. Ardian Hackaj

Drejtor i Shtetiweb.org

Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit

### **Pushteti mbi Ligjin dhe Roli i Shoqërisë Civile në Shqipëri**

*Pushteti mbi ligjin karakterizon një demokraci ku "...ligji është një instrument i qeverisë dhe qeveria konsiderohet mbi ligjin<sup>4</sup>".*

### **Një model demokracie për të gjithë**

Ndërtimi i demokracisë në Shqipëri nisi me shkatërrimin e regjimit komunist dhe insticioneve të tij. Pak vëmendje iu kushtua blloqeve të vlefshme ekzistuese sociale, ekonomike dhe politike që mund të ripërdreshin. Nuk iu dha rëndësi as tabanit nga ku institucionet e reja demokratike do të merrnin "gjakun e ri demokratik", apo procesit të saj të verifikimit. Në përgjithësi, në qoftë se ndryshimi i regjimit në Ballkanin Perëndimor ishte rezultat i një lëvizje popullore, ndërtimi i insticioneve të reja demokratike ishte një proces i shtyrë nga elita, i projektuar dhe inkurajuar nga demokracitë perëndimore.

### **Lista e kërkesave të demokracisë**

Demokratizimi, për të qenë eficient, u projektua si një proces i orientuar nga rezultatet, me rezultate të matshme dhe me mundësi vlerësimi çdo "arritje demokratike". Partitë e djathta politike u krijuan në kohë, shpesh me anëtarë nga Partia e vjetër komuniste. Një krah modern ekzekutiv dhe një parlament i zgjedhur në mënyrë demokratike, u ngritën me ndihmë teknike nga jashtë. Sistemi i vjetër i drejtësisë u shpërbë dhe u rregullua me ngut përmes seancash trajnuese gjashtë mujore (në një rezort turistik) dhe i cili siguroi gjyqtarët e rinj mjaft të nevojshme që do të bëheshin kujdestarët e shtetit të së drejtës. Teknika të ngjashme për ndërtimin e insticioneve u aplikuan për të krijuar median dhe shoqërinë civile. E thënë thjesht, ndërtimi i demokracisë në Shqipëri u bazua në skemën Perëndimore, me objektivat e saj të llogaritshme, veprime efikase dhe të matshme, të fokusuar në atë që mund të bëhet në kohën më të shkurtër. Pothuajse të gjitha përpjekjet u përqendruan në kryeqytet, Tiranë. Si pasojë blloqet historike të ndërtimit të kapitalit social shqiptar që përcaktojnë cilësinë e demokracisë së një vendi, u injoruan. Familja, komuniteti, fshati, lagjja, qyteti, komunitetet e bazuara tek puna, etj, humbën trenin e demokratizimit.

### **Demokraci e huazuar**

Si rezultat, individët më oportune - jo ata më demokratë apo më profesionistë – ishin ata që përfituan nga hapja e këtij tregu të ri në ndërtimin e insticioneve demokratike. Ata arritën të konvertonin institucionet e përcaktuara në mënyrë demokratike në mjete që i shërbyen të paktën në frymë, interesave të banorëve

---

4. UN Chronicle – the Magazine of the United Nations, at <http://unchronicle.un.org/article/rule-law-and-democracy-addressing-gap-between-policies-and-practices/>

të tyre të rinj. Sot këto institucione po provojnë të jenë një pengesë për një funksionim tërësisht të plotë të shtetit demokratik, të përfshirë në akuzat e korrupsionit, klientelizmit dhe imunitetit nga ligji. Qytetarët morën demokracinë por elitat e reja morën institucionet. Sundimi i ligjit devijoi në pushtetin mbi ligjin, një demokraci e modelit Potemkin e karakterizuar nga transferimi masiv i të ardhurave nga qytetari tek elitat politike, vendosja e kufijve të paqartë mes politikës dhe biznesit, dhe paradoksit të institucioneve demokratike që mbrojnë një sistem me të meta.

### **Aktorët e shoqërisë përballë institucioneve të kontrolluara nga elita**

Ky sistem është i destinuar të dështojë në periudhë afatgjatë për shkak të keq- shpërndarjes së burimeve dhe tensioneve sociale të krijuara nga pabarazia e padrejtë dhe e skajshme që ajo prodhon. Aktualisht qeveria Rama ka nisur reformat shumë të nevojshme, por e gjen veten përballë sfidës së saj më të madhe - reformimit të institucioneve kundër vullnetit të banorëve aktuale. Në këtë moment, aktorët e shoqërisë shqiptare mund të kontribuojnë përmes rritjes së monitorimit të institucioneve publike, analiza të paanshme dhe profesionale të politikave publike, informimit të qytetarëve, mobilizimit të energjisë dhe dijes së komunitetit, partneriteteve rajonale, dhe eksplorimit të zgjidhjeve alternative dhe të përshtatura. Kjo përfshirje mund të sigurojë atë “*suplement*” shumë të nevojshëm që mund të ofrojë balancën në favor të reformave.

Gjithashtu, statusi kandidat i BE-së siguron shinat në të cilat duhet të avancojë treni i reformave shqiptare. Për të marrë më të mirën e shoqërisë shqiptare, ndihma e BE-së duhet të rrisë mbështetjen e saj drejt valorizimit të blloqeve themelore ekzistuese si kapitali social, familja, komuniteti, lëvizjet nga poshtë-lart, sindikatat moderne tregtare, etj. Kjo do të jetë shoqëria shqiptare që do të duhet të sigurojë atë energji për të cilën kanë nevojë institucionet e vërteta demokratike, që ato të funksionojnë siç duhet.

## Gjetjet kryesore të Panelit të Tretë

- ❖ Nevoja për rol aktiv të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor duke marrë parasysh nivelet e organizimit të opozitës, kapjen e medias nga shtetit, etj.
- ❖ Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit dhe BE-së është një proces gjithëpërfshirës dhe duhet të përfshijë të gjithë aktorët e shoqërisë, jo vetëm përfaqësuesit e qeverisë. Feja është duke pasur një rol në rritje në shoqërinë e Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Demokracia funksionale po sakrifikohet për hir të stabilitetit në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Veprimet e shoqërisë civile dhe rezultatet e tyre treguar rëndësinë e përqasjeve nga poshtë-lart në avancimin e procesit të integrimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Mungesa e infrastrukturës së komunitetit dhe infrastrukturës sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- ❖ Integrimi rajonal i Ballkanit Perëndimor është një domosdoshmëri që do të nxisë një integrim dhe bashkëpunim më të ngushtë midis komuniteteve dhe entiteteve të ndryshme dhe do të sjellë zgjidhje për përplasjet dhe mosmarrëveshjet etnike, duke kontribuar kështu në integrimin evropian të të gjitha vendeve të rajonit.
- ❖ Nevoja për mekanizma mbështetëse në favor të integrimit në BE, duke përdorur mjetet e diplomacisë kulturore, konferenca, aktivitete kulturore dhe akademike, aktivitetet e shoqërisë civile, etj, që kontribuojnë për një integrim më të ngushtë rajonal, duke përdorur modelin e skemave ekzistuese të bashkëpunimit të BE-së.
- ❖ Diplomacia Juridike - nevoja për të bashkëpunuar në luftën kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky bashkëpunim dhe efektiviteti në forcimin e shtetit të së drejtës përmes bashkëpunimit mes vendeve, do të garantojë suksesin ekonomik. Ekonomia përcakton politikën dhe ajo duhet të jetë më gjithëpërfshirëse.



## Konkluzionet e Konferencës

### Profesor Rexhep Meidani

1. Nisur nga tematika e 3 paneleve dhe diskutimet tek to, mund të flitet për tri lloje integrimesh: a) për integrimin brenda vendit, kohezionin dhe ndërveprimin midis grupimeve e bashkësive, sidomos atyre etnike (p.sh., në Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoni, Kosovë, Serbi); b) integrimi në nivel rajonal, ku është e domosdoshme që Kosova të përfshihet në të gjithë veprimtaritë, strukturat e instrumentet rajonale në veprim; c) integrimi evropian. Në funksion të këtyre integrimëve kërkohen të zhvillohen më tej e drejt mekanizma të vjetër dhe të rinj ekonomikë. Por, krahas tyre, në shërbim të zhvillimit dhe të mirëqenies, rindërtimit të besimit midis popujve duhet të futen në veprim edhe mjete e rrugë të tjera që lidhen me diplomacinë kulturore (përfshirë dhe atë mësimore e shkencore, artistike e sportive); diplomacinë social-ekonomike dhe atë juridike; diplomacinë rinore e turistike (takime të rinjsh, olimpiada të ndryshme në fusha të ndryshme, shkëmbime vizitash nxënësish e mësuesish, etj.).

Më poshtë, po përpiqem të përmbledh në një plan më përgjithësues idetë e trajtuara në këto panele, para brenda kuadrit të diplomacisë kulturore e ekonomike.

2. Konkretisht, në trajtimin e tematikës së mësipërme, sipas referimeve një përmasë të re ka filluar të marrë edhe *diplomacia kulturore*, dialogu kulturor e konstruktiv, përmirësimi i komunikimit e kooperimit të shumanshëm, hedhja poshtë e keqkuptimeve, minimizimi i konflikteve sociale e etnike-kulturore, i pasojave të tyre. I tillë, është, p.sh., dialogu e bashkëveprimi midis drejtuesve dhe komuniteteve fetare në Shqipëri, i konsideruar si model rrezatues edhe nga Ati i Shenjtë. Po ashtu, një nxitje me vlera ishte dhe dialogu Serbi-Kosovë, pavarësisht që ende sot Serbia ka mbetur peng i një të kaluarë shekullore kolonialiste mbi Kosovës...

Sidoqoftë, si koncept, diplomacia kulturore nuk është diçka e re. Në shekuj, eksplorimi e tregtia kanë mundësuar shkëmbimin e ideve, njohjes, praktikave konkrete, mallrave të ndryshme, përfshirë ato kulturore. Aktorë të ndryshëm kanë shërbyer si “*diplomatë kulturore*”, qoftë me veshje tregtari, eksploratori, fetari e misionari, shtegtari, mësuesi, artisti, atleti, etj. Sot mjaft artistë, shkrimtarë, gazetarë, etj., të kalibrit ndërkombëtar shërbejnë si ambasadorë kulturorë nëpër botë. E njëjta gjë vlen edhe në nivel rajonal, siç është, p.sh., bashkëveprimi dhe gara midis shkrimtarëve në rajonin e Ballkanit. Por, problemi bëhet serioz kur aspekte të diplomacisë sportive (kulturore) bëjnë të kundërtën, e nxisin përplasjen, krijojnë tensione etnike, zgjojnë urrejtjen e fjetur.

Pjesë të diplomacisë kulturore janë edhe iniciativa të ndryshme në fushën mësimore, akademike e shkencore, si *Procesi i Bolonjës*, programet *Humboldt*, *Schuman*, etj.; programe të tilla si *TEMPUS*, *ERASMUS* në kuadër të BE-së; konferencat e kongreset shkencore, olimpiadat shkencore, etj. Po aq të rëndësishme mbeten veprimtaritë në nivelin e OJQ-ve dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Edhe takimet e ndryshme politike të formateve të ndryshme, krahas përmbajtjes konkrete politike, mishërojnë një aspekt konkret, shpesh tepër të rëndësishëm, të diplomacisë kulturore. Këtij qëllimi i shërbeu dhe takimi i Berlinit i 28 gushtit. Aq më tepër, që dhe aleanca të ndryshme farkëtohen shpesh, jo vetëm sipas linjave ekonomike e gjeografike, por dhe atyre kulturore-gjuhësore.

3. Edhe *diplomacia ekonomike*, e kombinuar me diplomacinë tradicionale, ndihmon në rritjen e

ndikimit politik-ekonomik. Edhe ky perceptim i diplomacisë ekonomike nuk duhet konsideruar si i ri. Në krijimin e tij, një kontribut të madh ka dhënë, p.sh., “*diplomacia komerciale*” e shteteve evropiane në shekullin e 19-të; “*diplomacia e dollarit*” në fillimet e shekullit të 20-të. Por, sot, në këtë gjallërim të ri të saj një rol të pazëvendësueshëm ka procesi i globalizimit. Madje, janë krijuar kushte të reja, për të gjitha vendet, për të adoptuar një diplomaci ekonomike më aktive. Këtë ilustron edhe marrëdhëniet ShBA- Kinë, ku konsideratat e biznesit peshojnë mbi marrëdhëniet politike (apo diferencat ideologjike). Me peshë janë instrumentet e diplomacisë ekonomike në BE (si *Euro*, *Traktati i Lisbonës*, deri tek *Takimi i Berlinit* me drejtuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor); apo ato në ShBA (*diplomacia e dollarit* e Traft-it, *mekanizmat e Bretton Woods*, *Plani Marshall*, etj.).

Në këtë kuptim, *politika nuk është më ajo që udhëheq ekonominë, por ekonomia drejton politikën*, d.m.th., konsideratat ekonomike duhet të jenë pararoja e përpjekjeve tona në rajon. Këtë nënkupton dhe integrimi ekonomik rajonal. Prandaj, kishte të drejtë Xhorxh Soros, në vitin 1999, kur hodhi idenë e një tregu të përbashkët ballkanik nëpërmjet unifikimit doganor, gjë që nuk u mbështet nga politika ballkanike, duke krijuar kështu shpejtësi të ndryshme integrimi, në përputhje dhe me interesa konkrete gjeopolitike. Por, në gjykimin tim, ndryshe nga ideja e Prof. Civicit<sup>5</sup>, për ndërveprim ekonomik rajonal të tipit të Beneluxit, sot, diçka e tillë, nuk ka më kuptim për vendet e mbetura ballkanike, sepse tek ata procesi i integritimit evropian është tashmë i projektuar dhe po ndjek, hap pas hapi, matricën e vet evropiane! Më kryesore, aty, është që ky proces të jetë i njëkohshëm për të gjithë këto vende ballkanike, për të mos lejuar ngërçe apo veto të panevojshme në vendimmarrjet konkrete...

Së fundi, edhe diplomacia ekonomike, këtu, *nuk ka asgjë të re!* Ajo, sot, krahas investimeve, kreditimit apo huadhënies, ndihmave, marrëveshjeve të tregtisë së lirë, etj.; përmbledh dhe çështje konkrete të politikës ekonomike, p.sh., veprimtaritë konkrete të delegacioneve vendore në struktura të tilla si OBT, BB, FMN, etj. Në këtë kuptim, ajo aktivizon jo vetëm *burimet ekonomike*, por dhe *sanksionet* (siç ndodhi, p.sh., ndaj Serbisë gjatë krizës kosovare, apo ndaj Rusisë në krizën ukrainase). Por, po ashtu, nuk duhen lënë mënjane edhe “*shpërblimet*”, sidomos ndaj biznesit. Kjo duhet të kihet shumë mirë parasysh në kushtet tona shqiptare e rajonale...

5. *Beneluxi (Benelux)*, si term, vjen nga kombinimi i germave të para për 3 vendet fqinje: Belgjikë, Holandë e Luksemburg (**B**elgium +**N**etherlands +**L**uxembourg). Ai është një bashkim ekonomik i këtyre vendeve bazuar në një marrëveshje doganore (të firmosur në 1944). Sot, ky term, përdoret në mënyrë më të përgjithësuar si referencë e këtij grupimi gjeografik, ekonomik e kulturor.